
İM@



# POLARIZIMI ETNIK NË MEDIAT DHE KOMUNIKIMIN PUBLIK GJATË PROCESEVE ZGJEDHORE

**BOTIM ELEKTRONIK:**

# POLARIZIMI ETNIK NË MEDIAT DHE KOMUNIKIMIN PUBLIK GJATË PROCESEVE ZGJEDHORE

## (ANALIZA)

# BOTIM ELEKTRONIK: POLARIZIMI ETNIK NË MEDIAT DHE KOMUNIKIMIN PUBLIK GJATË PROCESEVE ZGJEDHORE (ANALIZA)

**Botues:**

Instituti për Media dhe Analitikë IMA Shkup

**Redaktorë:**

Petrit Saraçini, kryetar i IMA

Zharko Trajanoski, drejtues i hulumtimeve në IMA

**Autorë:**

Zharko Trajanoski

Dr. Mirjana Maleska

Dr. Sefer Tahiri

**Përkthimi:**

Meriton Tusha

**Dizajni:**

Jane Stefanov

Shkup, qershor 2024

*Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Fondit Evropian për Demokraci (FED) - European Endowment for Democracy (EED). Përmbajtja e tij nuk pasqyron domosdoshmërisht opinionin zyrtar të EED. Përgjegjësia për informacionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim i takon tërësisht autorit(ëve).*

# PËRMBAJTJA

HYRJE ..... 5

**ZHARKO TRAJANOSKI**
POLARIZIMI ETNIK DHE POLITIK NË KONTEKSTIN E ZGJEDHJEVE TË VITIT 2024 ..... 7

**prof. MIRJANA MALESKA**
FUSHATA PARAZGJEDHORE DHE MARRËDHËNIET NDËRETNIKE: FITORE E HIDHUR E NACIONALIZMIT..... 25

**DR. SEFER TAHIRI**
MARRËDHËNIET NDËRETNIKE NË KOMUNIKIMIN PUBLIK GJATË ZGJEDHJEVE: VAZHDON DOMINIMI I DISKURSIT ETNOCENTRIK ..... 37

# Hyrje

Publikimi: "Polarizimi etnik në mediat dhe komunikimin publik gjatë proceseve zgjedhore (analiza)", sjell analiza nga Zharko Trajanoski – drejtues i hulumtimeve në IMA, prof. dr. Mirjana Maleska – profesoreshë universitare e shkencave politike dhe prof. dr. Sefer Tahiri – profesor universitar i gazetarisë dhe shkencave të komunikimit, autorë të dalluar me përvojë shumëvjeçare në hulumtimin e komunikimit politik dhe mediatik lidhur me marrëdhëniet ndëretnike.

Qëllimi i analizave është të zbulojë narrativat dhe modelet kryesore të polarizimit etnik në raportimin mediatik dhe komunikimin publik të pjesëmarrësve në proceset zgjedhore në vend, si dhe të shpalosë zgjidhjet e mundshme për zvogëlimin e dëmeve të shkaktuara nga polarizimi etnik i shoqërisë.

Publikimi është pjesë e aktiviteteve të Institutit për Media dhe Analitikë IMA të mbështetura nga Fondi Evropian për Demokraci (European Endowment for Democracy) nga Brukseli, dhe është një kontribut në realizimin e angazhimeve të IMA për promovim të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, përmes bashkëpunimit me institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, në drejtim të ballafaqimit me dëmet nga polarizimi, gjuha e urrejtjes, dezinformatat dhe sulmet ndaj mendimtarëve kritikë në media dhe në komunikim publik.

*Instituti për Media dhe Analitikë IMA - Shkup*

# 1. POLARIZIMI ETNIK DHE POLITIK NË KONTEKSTIN E ZGJEDHJEVE TË VITIT 2024

Shkruan: ZHARKO TRAJANOSKI

Polarizimi është theksuar vazhdimisht si një nga problemet më të mëdha në vend,[1] dhe konstatimet, paralajmërimet dhe rekomandimet për adresimin e problemit të polarizimit shoqëror, politik, mediatik dhe etnik mund të lexohen në raporte të ndryshme relevante për Maqedoninë e Veriut.

Instituti për Media dhe Analitikë IMA ka detektuar polarizim në baza etnike[2], si para debatit për amendamentet kushtetuese në vitin 2023,[3] ashtu edhe në kuadër të debatit për ndryshimet kushtetuese të iniciuara,[4] të cilat u vendosën si kusht për vazhdimin e negociatave me BE-në· Në vjeshtën e vitit 2023, IMA vuri në dukje publikisht fushatat e dëmshme me narrativa propagandistike që «forcojnë frikën, mosbesimin dhe ndezin pasionet etno-nacionaliste, jo vetëm midis maqedonasve etnikë, por edhe midis pjesëve të tjera të popujve në Maqedoninë e Veriut, madje edhe më gjerësisht në Ballkan".[5]

Narrativat etnocentrike që nxitën polarizimin etnik dhe ndezën pasionet etno-politike ishin gjithashtu një tipar i dallueshëm në vitin 2024, veçanërisht në kontekstin e fushatës për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2024, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it detektoi jo vetëm "polarizim dhe fragmentim të fuqishëm politik", por edhe "polarizim të dukshëm përgjatë vijave politike dhe etnike».[6] OSBE/ODIHR bëri me dije publikisht se gjatë fushatës kishte vërejtur "raste të retorikës diskriminuese, duke përfshirë përdorimin e parullave nacionaliste, si dhe disa raste në të cilat veprimet e partive politike ishin të përziera me ato të komuniteteve etnike".[7]

Edhe Instituti për Media dhe Analitikë IMA në vitin 2024 detektoi një thellim të polarizimit politik dhe etnik, përmes përdorimit të narrativave të dëmshme propagandistike, të cilat jo vetëm që ndezin pasionet etno-nacionaliste, por edhe nxisin diskriminimin dhe urrejtjen në baza etnike, nacionale dhe politike. Në këtë analizë do të japim disa shembuj karakteristikë të narrativave etnocentrike, të cilat kanë qenë pjesë e komunikimit publik dhe mediatik para, gjatë fushatës dhe pas mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare në vitin 2024 dhe që kanë kontribuar në thellimin e polarizimit etnik në vend.

## 1) Polarizimi etnik me narrativën e maqedonasve etnikë si "qytetarë të rendit të dytë" në "shtetin e tyre"

Narrativa politiko-propaganduese se maqedonasit etnikë janë "qytetarë të rendit të dytë në shtetin e tyre" është ushqyer me vite në komunikimin publik nga disa subjekte politike, duke përfshirë parti dhe politikanë me orientim të qartë pro-rus. Për shembull, Janko Baçev, kreu i partisë "Edinstvena Makedonija ("Maqedonia e Bashkuar", e quajtur sipas "Rusisë së Bashkuar" të Putinit), në vitin 2022 pohonte se "në Maqedoninë me

shumicë maqedonase dhe ortodokse, ne maqedonasit jemi bërë të huaj dhe qytetarë të rendit të dytë".[8] Për vite të tëra, Baçev dhe partia e tij drejtuan porosi se maqedonasit janë "të huaj dhe qytetarë të rendit të dytë në shtetin e tyre", e porosi të ngjashme u drejtuan nga parti dhe politikanë të tjerë pro-rus.[9]

Në zgjedhjet e vitit 2024, propagandistët pro-rusë në mënyrë eksplicite i shpallën shqiptarët në Maqedoni si qytetarë të rendit të parë dhe maqedonasit si "qytetarë të rendit të dytë në shtetin e tyre nacional"[10].

Narrativa politiko-propaganduese se maqedonasit etnikë janë "qytetarë të rendit të dytë në shtetin e tyre" është ushqyer edhe më parë nga VMRO-DPMNE dhe lideri i saj Hristijan Mickoski, dhe njihej si një nga narrativat kryesore politike në fushatën për zgjedhjet e dyfishta në vitin 2024. Për shembull, qysh në vitin 2019, Mickoski në mënyrë eksplicite theksoi se te maqedonasit etnikë mbizotëron ndjenja se ata janë "qytetarë të rendit të dytë në shtetin e tyre". [11] Duke agjituar në zonat ku jetojnë kryesisht maqedonas etnikë, VMRO-DPMNE dhe Mickoski vazhdimisht drejtonin porosi se maqedonasit etnikë ishin qytetarë të rendit të dytë (edhe pse rregullisht paguanin faturat dhe taksat), dhe se shqiptarët etnikë ishin të privilegjuar. Për shembull, në një fjalim në korrik të vitit 2023 në Vevçan (komuna më e vogël me 2359 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2021), ku jetojnë kryesisht maqedonas etnikë, Mickoski nxiste pasionet etnike me narrativën e "qytetarëve të rendit të dytë", duke pretenduar se qytetarët e Sllupçanit, ku jetojnë kryesisht shqiptarë etnikë, ishin të privilegjuar, edhe pse atje jetojnë më shumë qytetarë dhe nuk e kanë komunën e tyre.[12] Një narrativ i tillë etnocentrik për qytetarët e rendit të parë dhe të dytë, i cili i përgjithësonte, i ndante dhe i vinte në kundërshtim qytetarët e Vevçanit (si qytetarë të rendit të dytë) me qytetarët e Sllupçanit (si qytetarë të rendit të parë), ndezte pasionet etno-nacionaliste dhe thellonte polarizimin etnik dhe politik.

Në fushatën e VMRO-DPMNE-së në vitin 2024, kjo narrativë etnocentrike u zgjerua dhe u mbindërtua me pretendimin se jo vetëm që maqedonasit ishin qytetarë të rendit të dytë, por ese të tillë ishin të gjithë qytetarët e tjerë, pa dallim etnie, e që nuk ishin pjesë e elitës qeverisëse të LSDM-së dhe BDI-së

Lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski që në konventën e partisë më 30.03.2024 ka tentuar të distancohet se "sulmi ndaj BDI-së nuk është kurrë sulm ndaj shqiptarëve, por sulm ndaj krimit që ata përfaqësojnë dhe avokojnë", duke akuzuar ashpër BDI-në se dëshiron ta shkatërrojë Maqedoninë, si në vitin 2001.[13]

Edhe në tubimin para qeverisë më 04.04.2024, Mickoski përdori narrativën se "maqedonasit janë qytetarë të rendit të dytë", në formë të zgjeruar dhe të mbindërtuar, duke shënjestruar liderin e LSDM-së dhe "shërbëtorët e LSDM-së" sepse " shtetin ia dhuroi Ali Ahmetit edhe atë në pjatë".[14]

Megjithatë, përkundër faktit se narrativa e "qytetarëve të rendit të dytë" u zgjerua e u mbindërtua dhe u përdor kryesisht në fushatën e VMRO-DPMNE-së për të shënjestruar BDI-në, [15]politikanët nga BDI, [16] nga LSDM [17]dhe disa analistë, nuk e perceptuan atë si "qytetare", [18] por si një narrativë etno-nacionaliste. Mes tjerash, edhe për shkak të nëntekstit,[19] si dhe për shkak të historisë së mëparshme të përdorimit të saj si instrument për mobilizimin etno-nacionalist, dhe për shkak të mesazheve implicite që ushqenin ndjenjat etno-nacionaliste te maqedonasit etnikë.[20]

Përveç kësaj, narrativa për maqedonasit etnik si qytetarë të rendit të dytë u përdor edhe nga kandidatë dhe parti të tjera gjatë fushatës zgjedhore, si narrativë për mo-

bilizimin etno-nacionalist. Për shembull, kandidatja për presidente nga partia E Majta, Biljana Vankovska, shprehimisht në fushatë dha deklaratë se "nacionalizmi maqedonas është në defensivë, ne po bëhemi qytetarë të rendit të dytë në shtetin tonë",[21] pas së cilës E Majta dërgoi mesazhin "Pse etiketohet nacionalizmi maqedonas si diçka e keqe". [22] Fushata e Vankovskës me pretendimin se "maqedonasit ndjehen si qytetarë të rendit të dytë" ishte në kontekstin e sloganit të saj "Maqedonia është gjithçka që ne nuk e kemi" [23] dhe ofertës së saj për të ndërprerë tre marrëveshjet, të cilat sipas saj poshtërojnë qytetarët maqedonas – Marrëveshja e Ohrit, e Prespës dhe Marrëveshja me Bullgarinë.[24]

Një nga mesazhet kryesore të liderit të partisë E Majta, Dimitar Apasiev, ishte mesazhi etnocentrik se "me Të Majtën maqedonasi nuk është më dhe nuk do të jetë më inferior në vendin e tij", [25] i cili ishte pjesë e një videoje të publikuar në rrjetet sociale, e cila vetëm në faqen e partisë E Majta në Fejsbuk kishte mbi 1.1 milionë shikime.

Edhe lideri i ZNAM-it dhe kandidat për president, Maksim Dimitrievski në fushatë drejtoi porosi etnocentrike, se te maqedonasit është krijuar ndjenja se janë qytetarë të rendit të dytë, [26] se janë bërë qytetarë të rendit të dytë [27] dhe se ai nuk do lejojë maqedonasit të jenë qytetarë të rendit të dytë në vendin e tyre. [28] Gjatë fushatës, Dimitrievski u përpoq të mobilizonte votues duke pretenduar se pjesëtarët e popullit maqedonas duhet të jenë "qytetarë të rendit të parë".[29]

Edhe pse narrativa etno-nacionaliste për maqedonasit si qytetarë të rendit të dytë, e përdorur në fushatat kundër BDI-së, u "demantua" edhe nga përfaqësuesit e BDI-së,[30] ose u shpjegua me shprehjen "paragjykime në komunitetin maqedonas",[31] megjithatë, disa prej tyre nuk e fshehën se "nacionalizmi lind nacionalizëm" dhe se kjo i kontribuon mobilizimit partiak edhe në BDI.[32] Mobilizimi partiak me brohoritjet "UÇK", të cilësuara nga Ali Ahmeti si "të natyrshme",[33] si dhe përballja personale e Ahmetit (i cili kujtoi se ka hyrë në politikë si "kryengritës") [34] dhe Mickoskit, padyshim e thelluan polarizimin etno-politik. Këtë e dëshmojnë reagimet e ashpra politike ndaj deklaratave të Ahmetit[35], të perceptuara si kërcënime[36]

Mirëpo, ndryshe nga shpërthimet militante etno-nacionaliste[37] dhe ndezja e tensioneve ndëretnike ndërmjet VMRO-DPMNE-së dhe BDI-së (që u interpretua edhe nga LSDM-ja si përpjekje për të mbledhur vota politike[38]), pas zgjedhjeve, narrativa për "qytetarë të rendit të dytë" mori një konotacion krejt tjetër.[39] Pas konstituimit të Kuvendit dhe zgjedhjes së Afrim Gashit për kryetar të ri të Kuvendit, pasi Mickoski mori mandatin për formimin e qeverisë, narrativa e "qytetarëve të rendit të dytë" sikur e humbi dimensionin e saj etnik.[40]

Shkurtimisht, narrativa propagandistike për "qytetarët të rendit të dytë», nga një narrativë e pastër etno-nacionaliste ("Maqedonasit janë praktikisht qytetarë të rendit të dytë" - Mickoski në vitin 2019), u transformua gradualisht gjatë fushatës, kështu që pas zgjedhjeve mori formën e një narrative në dukje «qytetare» («që të mos ketë qytetarë të rendit të parë dhe të dytë…» - Mickoski, si mandatar).

Padyshim, gjatë fushatës zgjedhore, disa aktorë politikë e instrumentalizuan mediatikisht dhe politikisht narrativën etno-nacionaliste se maqedonasit si popull shumicë janë poshtëruar, nënshtruar dhe të reduktuar në qytetarë të rendit të dytë "në shtetin e tyre". Një narrativë e tillë kontribuoi në nxitjen e pasioneve etno-nacionaliste dhe thellimin e polarizimit politik dhe etnik. Fatkeqësisht, në këtë kontribuuan edhe një sërë mediash, të cilat duke përcjellë dhe theksuar mesazhet etnonacionaliste në mënyrë jokritike, ato vetë dhanë kontribut në rritjen e polarizimit etnik dhe shoqëror.

## 2) Narrativat politiko-propaganduese kundër "shqiptarizimit" dhe "kosovizimit", kundër "ballistëve" dhe "neoballistëve"

Narrativat ndezëse etno-nacionaliste kundër "shqiptarizimit" u instrumentalizuan nga faktorët politikë pro-rusë në vend, si para, e veçanërisht pas formimit të qeverisë së koalicionit LSDM-BDI. [41] Ndoshta shembulli më i qartë i të gjuhës nxitëse që përmban teori konspirative të «shqiptarizimit të plotë» është një nga narrativat e partisë pro-ruse «Rodina» .[42]

Akuzat për "shqiptarizim të shtetit" nuk u drejtuan vetëm ndaj LSDM-së në pushtet, por edhe ndaj BDI-së dhe zyrtarëve të saj, nga partnerët e koalicionit të VMRO-DPMNE.[43] Akuzat nxitëse se LSDM në pushtet lejoi "shqiptarizimin e plotë të shtetit" u përforcuan nga mediat që favorizonin VMRO-DPMNE-në dhe partnerët e saj të koalicionit në fillim të vitit 2024.[44]

Për dallim nga partnerët e koalicionit, para dhe gjatë fushatës, partia VMRO-DPMNE nuk e përdorte termin "shqiptarizim" por "DUI-zim" (BDI-zim).[45] Pas zgjedhjes së Talat Xhaferit si shqiptar i parë etnik kryeministër në vend, VMRO-DPMNE akuzoi LSDM-në në pushtet dhe liderin e saj për "shkatërrimin e plotë të Maqedonisë".[46] Përkundër faktit se lideri i VMRO-DPMNE-së publikisht distancohej se "sulmi ndaj BDI-së nuk është sulm ndaj shqiptarëve" kur foli kundër "BDI-zimit apo më saktë kriminalizimit të shtetit",[47] mbetet e hapur pyetja nëse me narrativën kundër "BDI-zimit" u trajtuan në mënyrë pragmatike frikësimet imagjinare të maqedonasve etnikë për "shqiptarizimin" e Maqedonisë dhe humbjen e shtetit.[48]

Narrativa më eksplicite kundër "shqiptarizimit" u përdor nga E Majta. Në periudhën parazgjedhore, E Majta vazhdoi të përdorte narrativa nxitëse kundër "shqiptarizimit", "kosovizimit", kundër "ballistëve" dhe "neoballistëve", si pjesë e strategjive të komunikimit mobilizues. Strategji të tilla u përdorën nga E Majta edhe më parë - kundër "qeverisë balliste-vërhoviste",[49] kundër "ministrit ballist të drejtësisë" dhe Gjykatës Kushtetuese si " vëzhguese memece e demaqedonizimit ballist" (me gjuhë urrejtjeje kundër presidentes), [50]kundër "ringjalljeve balliste" pas debatit parlamentar për ndryshimet kushtetuese.[51]

Me përparimin e fushatës së 2024-ës, u bënë edhe përpjekjet e partisë E Majta për mobilizimin etno-nacionalist përmes narrativave kundër «shqiptarizimit» dhe «kosovizimit», kundër «ballistëve» dhe «neoballistëve». Që në fillim të vitit 2024, E Majta (Levica) u promovua si parandaluese e "shqiptarizimit kontrabandues" të institucioneve shtetërore dhe aplikimit të "Ligjit për përdorimin e gjuhëve".[52] Më 17 shkurt 2024, duke shpërndarë lajmin "Me intonimin e himnit kombëtar shqiptar, në ditën e pavarësisë së Kosovës, partitë opozitare nga blloku shqiptar nënshkruan Deklaratën e Bashkimit ", lideri i partisë E Majta, Dimitar Apasiev postoi një status në Fejsbuk "Vota për DPMNE-në është votë për SHQIPTARIZIMIN e Maqedonisë!", me hashtag "#КоалиционитеПартнери " (partnerët koalicionues). Me narrativa nxitëse kundër "ballistëve", E Majta sulmoi kryetarët e komunave në Tetovë[53] dhe Kumanovë, duke dërguar mesazhin se "bashkëjetesa me ballistët nuk ka pasur e as nuk do të ketë". [54] Gjatë fushatës, përfaqësuesit e partisë E Majta bënë fushatë edhe kundër «shqiptarizimit të popullit turk në Maqedoni» dhe «komuniteteve të tjera më të vogla të kombësive".[55] Lideri së Majtës nga Velesi akuzoi rivalët politikë LSDM dhe VMRO-DPMNE se "pushteti i tyre është UÇK-ja, ata që shkarravitën mbi punëtorët tanë mavrovas".[56]

Edhe "platforma maqedonase" e së Majtës etnonacionaliste u promovua në media si mburojë për "shantazhimin nga partitë neoballiste" dhe "shantazhimin nga ballistët",[57] përkundër "platformës së Tiranës" (të BDI-së dhe VLEN-it).[58] dhe "Platformës së Sofjes" (të LSDM-së dhe DPMNE-së).[59] Një nga mesazhet kryesore të liderit të partisë E Majta, Dimitar Apasiev, i cili u bë viral në rrjetet sociale,[60] ishte se "Hyrja e së Majtës në Kuvend me një numër më të madh deputetësh do të nënkuptonte digë kundër të gjitha politikave të dëmshme të kosovarizimit dhe bullgarizimit i shtetit!"· Një nga videot më të shikuara të postuara nga Apasiev në faqen e tij në Fejsbuk është me një mesazh kundër "shovinizmit të shqiptaromadh", karshi pjesëve nga tubimi i BDI-së ku Ahmeti thërret "UÇK, UÇK".[61]

Edhe pas zgjedhjeve, E Majta vazhdoi me mesazhe nxitëse, kundër "ballistëve" dhe "ballizmit" te shqiptarët[62] dhe kundër "retorikës neoballiste të partive politike të të ashtuquajturit "blloku shqiptar".[63] Kreu i kësaj partie, Apasiev, e sulmoi hapur VLEN-in si "neoballistë" që luajnë në kartën e "Shqipërisë së Madhe".[64]

Para votimit për kryetarin e ri të Kuvendit, lideri i partisë E Majta deklaroi publikisht se gjashtë deputetët e tyre do të mbështesnin "që shqiptari të mos jetë kryetar i Kuvendit" dhe i dha publikisht "mbështetje pakusht" Mickoskit, me mesazhin, "vetëm që parlamenti maqedonas të mos kosovarizohet sërish".[65] Disa media kanë raportuar edhe për akuzat e Apasievit se Afrim Gashi ishte "neoballist" dhe "maqedonofob".[66] Pas zgjedhjes së kryetarit të ri të Kuvendit, E Majta akuzoi se "Sot platformën e Tiranës e shpërblyem me platformën KOSOVARE" dhe "Neoballistët e BDI-së i zëvendësuam me neoballistët e VLEN-it".[67] Akuzat nxitëse të Apasievit ndaj Mickoskit se "është në anën e kosovarizimit të parlamentit maqedonas",[68] dhe narrativa e partisë E Majta kundër "kosovizimit" u përforcuan jo vetëm nga mediat maqedonase, por edhe nga ato serbe. Për shembull, "Politika" serbe publikoi titullin "Maqedonia e Veriut kërcënohet me 'kosovizim'", duke pohuar se koalicioni VLEN e kishte shpallur Kurtin "presidentin e të gjithë shqiptarëve në Kosovë», duke e lidhur Kurtin me idenë e "Shqipërisë së madhe".[69]

Levica e intensifikoi narrativën ndezëse kundër "strukturave neoballiste në Maqedoni", duke i akuzuar se kanë mbështetjen e "patriotëve" të DPMNE-së për shkatërrimin e plotë të shtetit maqedonas dhe çojnë drejt federalizimit të tij territorial dhe gjuhësor me qëllimin përfundimtar – ringjalljen e krijimit fashist: Shqipëria e Madhe."[70] Narrativa të tilla nxitëse dhe teori konspirative për shkatërrimin e shtetit maqedonas dhe për "Shqipërinë së Madhe", që shënjestronin shumicën e re parlamentare, thelluan edhe më tej polarizimin etnik dhe politik.

## 3) Narrativat etno-nacionaliste për marrëveshjet me Greqinë, Bullgarinë, "Propozimin francez" dhe "kornizën e negociatave" me BE-në.

Edhe në vitin zgjedhor 2024, në mediat maqedonase dhe në komunikimin publik, vazhdoi trendi i përhapjes së narrativave etno-nacionaliste me mesazhe frikësuese dhe kërcënime imagjinare[71] në lidhje me popullin maqedonas, gjuhën maqedonase dhe identitetin maqedonas, të cilat nxitën ndjenjën e rrezikut tek maqedonasit etnikë dhe polarizim etnik. Në vitin 2022, IMA veç më vuri në dukje se narrativat me dezinformim, frikësim dhe teori konspirative për identitetin maqedonas dhe popullin maqedonas pas

"propozimit francez", "ngritën panik nacionalist, nxitën pasionet etnike, nxitën urrejtje dhe jotolerancë ndaj BE-së dhe Bullgarisë dhe ndarje të mëtejshme të brendshme të linjës "patriotë" dhe "tradhtarë".[72] Gjithashtu, në vitin 2023, IMA vuri në dukje narrativat etno-nacionaliste, të cilat ringjallën dezinformatat e vjetra dhe teoritë e konspiracionit për "gjenocidin" dhe "etnocidin" ndaj popullit maqedonas,[73] si dhe teoritë e konspiracionit për "bullgarizimin" dhe dezinformatat për gjuhën maqedonase dhe historinë në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese.[74]

Në kuadër të zgjedhjeve të vitit 2024, do të japim vetëm disa shembuj të narrativave etnocentrike që lidhen me "propozimin francez", kornizën negociuese me BE-në dhe ndryshimet kushtetuese, si dhe narrativat për "demaqedonizim" dhe "bullgarizim", të cilat kanë kontribuar në thellimin e polarizimit etnik. Edhe mesazhet etnocentrike kundër Marrëveshjes së Prespës dhe Marrëveshjes me Bullgarinë, në radhë të parë nga e djathta "patriotike",[75] kontribuuan në mobilizimin, homogjenizimin dhe polarizimin etnik.

Narrativet etno-nacionaliste kundër "propozimit francez", të cilat u përforcuan edhe nga mediat, ishin pjesë integrale dhe thelbësore edhe e fushatës politike të vitit 2024. Për shembull, TV Alfa, në një kronikë të posaçme kundër "propozimit francez", e cilësoi atë si një propozim "me të cilin bullgarët u bënë edhe kusht për Bashkimin Evropian",[76] ndërsa disa media, si Nova Makedonija, e quajtën atë " Propozimi franko-bullgar"[77] ose "propozimi bullgar".

Gjatë fushatës, Mickoski ka dërguar mesazh se me "propozimin francez" Maqedonia është poshtëruar, se me të është bllokuar "rruga e integrimit evropian të Maqedonisë"[78] dhe ka akuzuar qeverinë se e ka distancuar Maqedoninë nga BE-ja duke pranuar "Propozimin francez".[79] Kandidatja për presidente nga VMRO-DPMNE, Gordana Siljanovska - Davkova, ia kujtoi kundërshtarit Pendarovski se fillimisht kishte thënë se "propozimi francez" duhet të refuzohet, por ai nuk ka mbetur në qëndrimit të tij.[80] Në programin e saj «Maqedonia përsëri krenare", Siljanovska-Davkova pohon se "Negociatat me BE-në vetëm janë hapur por nuk kanë filluar", se " po na imponohet identiteti maqedonas verior" dhe se "përdorimi i gjuhës maqedonase dhe emërtimi i saj në kornizа ndërkombëtare, na është kontestuar".[81]

Lideri i ZNAM-it dhe kandidati presidencial Maksim Dimitrievski pohoi se "propozimi francez" përmban thelbin e rezolutës bullgare me të cilën "ne jemi të mohuar si popull, komb, gjuhë, identitet, vazhdimësi".[82]

E Majta e sulmoi VMRO-DPMNE-në sepse është "në koalicion me një parti që tashmë e ka pranuar propozimin francez".[83] Kandidatja e partisë E Majta për presidente, Biljana Vankovska, akuzoi "pakurrizorët në qeverinë maqedonase" për "propozimin francez",[84] dhe në programin e saj pohoi se "i ashtuquajturi propozimi francez, pra korniza negociuese... e vendos shtetin jo vetëm në një pozitë të varur, por edhe të poshtëruar", dhe se "në kushte të tilla, rruga jonë drejt anëtarësimit të plotë është një rrugë e vetëshkatërrimit".[85] Vankovska i cilësoi "Marrëveshjet e Prespës dhe Bullgarisë" si "marrëveshje kolonizimi", si " marrëveshjet e elitave maqedonase kompradore që na shitën si në treg bagëtish, na hoqën identitetin dhe dinjitetin".[86] Lidhur me Marrëveshjen e Prespës, Vankovska ka pohuar shprehimisht se "ne kemi vendosur t'i japim mbrojtje juridike një marrëveshjeje që na zhvlerëson si popull, si identitet, si komb".[87]

Me narrativa të tilla politike kundër "propozimit francez" dhe marrëveshjeve me fqinjët, nga njëra anë u ushqye frika dhe u përhap paniku për anulimin e popullit,

identitetit dhe kombit maqedonas. Nga ana tjetër, narrativat e tilla rritën polarizimin etnik, në funksion të mobilizimit etno-partiak.

## 4. Narrativat për bullgarizim, "diktat bullgar", demaqedonizim

Narrativat kundër "bullgarizimit", që ishin narrativat politike dominuese të disa partive opozitare pas "propozimit francez"[88] dhe hapjes së negociatave me BE-në, u bënë pjesë karakteristike e diskursit politik dhe mediatik në vitin zgjedhor 2024.

VMRO-DPMNE-ja opozitare, e cila kultivoi narrativë politike kundër "bullgarizimit" gjatë "propozimit francez" në vitin 2022, e transformoi narrativën kundër ndryshimeve kushtetuese në vitin 2023 kryesisht duke përdorur shprehjen "diktati bullgar". Edhe gjatë fushatës së vitit 2024, VMRO-DPMNE dhe lideri i saj Mickoski vazhduan të dërgojnë mesazhe se "nuk mund ta pranojmë diktatin bullgar" dhe "nuk do të ketë ndryshime kushtetuese nën diktatin bullgar".[89]

Në kushte kur VMRO-DPMNE hoqi dorë nga shprehja polarizuese "bullgarizim" në komunikim, E Majta e pa shansin e saj politik për të promovuar veten si parti e vetme që ishte kundër "bullgarizimit të Kushtetutës".[90] Edhe "platforma maqedonase" e partisë E Majta u promovua, ndër të tjera, si platformë kundër "bullgarizimit të shtetit".[91]

Megjithatë, edhe pse shumica e partive pjesëmarrëse në protestat kundër "propozimit francez" në vitin 2022 u përmbajtën nga përdorimi i termit "bullgarizim", narrative polarizuese që nxisnin ndjenjat e rrezikut të asimilimit dhe bullgarizimit[92] ishin të dukshme në media dhe komunikimin publik gjatë fushatës (para)zgjedhore.

Për shembull, nga këndvështrimi etnocentrik, në një media që tradicionalisht promovon dhe forcon pikëpamjet e VMRO-DPMNE-së, pas raundit të parë, presidenti Stevo Pendarovski u akuzua për "bullgarizim stupid të Dellçevit, babait të kombit», ndërsa partia që e mbështeti nxihej si "anti-maqedonase".[93] Nga perspektiva etnocentrike, shqiptarët në krye të MPJ-së u akuzuan edhe për lehtësimin e " bullgarizimit të maqedonasve" nga ekspertë që përfaqësojnë tradicionalisht pikëpamje të afërta me VMRO-DPMNE-në.[94] Gazeta Nova Makedonija, çerdhe e narrativave etnocentrike,[95] vazhdoi të botojë analiza kundër marrëveshjes "bullgare", e cila bëri "bullgarizimin", si para, ashtu edhe pas zgjedhjeve.[96]

Krahas narrativave etnocentrike që paralajmëronin rrezikun e "bullgarizimit" dhe asimilimit, para, gjatë dhe pas zgjedhjeve, në media mund të detektohen edhe narrativa polarizuese që paralajmëronin rrezikun e "demaqedonizimit". Për shembull, narrativat etno-nacionaliste dhe anti-globaliste për "rrezikun real të demaqedonizimit dhe dehumanizimit të mbarë kombit" ishin tema e propaganduesve pro-rusë dhe teoricienëve të konspiracionit gjatë fushatës.[97]

Ndonëse narrativat etnocentrike për rrezikun e "demaqedonizimit" nuk u shpërndanë nga aktorët politikë si p.sh. para dhe pas Marrëveshjes së Prespës dhe në lidhje me "mbrojtjen e emrit", [98] ato u vunë re në media edhe në vitin 2024. Për përkujtim, termi "demaqedonizim" gjendet edhe në tekstet e Gordana Siljanovska Davkovës nga viti 2018,[99] në recensionin e saj "MBI "MARRËVESHJEN E PREPSËS" DHE MË GJERË",[100] ndërsa si kandidate e VMRO-DPMNE-së për kryetare të shtetit, ajo e përdori edhe në fushatën politike për zgjedhjet presidenciale 2019.[101] Termi "demaqedonizim" u përdor si në narrativet propagandistike të VMRO-DPMNE-së,[102] ashtu edhe në narrativet

propagandistike të partisë E Majta,[103] veçanërisht gjatë regjistrimit të popullsisë, i cili u bojkotua nga rrjeti i partive dhe organizatave pro-ruse, si "regjistrimi për demaqedonizim".[104]

Në fillim të vitit 2022 shprehja "demaqedonizim" kishte edhe "legjitimim shkencor" nga kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë. Në ekspozitën e kryetarit ASHAM, Lupço Kocarev të datës 23 shkurt 2022, ai theksoi se është e drejtë e shenjtë dhe detyrë e shenjtë e ASHAM "që t›u rezistojë të gjitha përpjekjeve për demaqedonizimin e Maqedonisë".[105] Një pjesë e mediave jo që vetëm përforcuan mesazhet për rrezikun e "demaqedonizimit",[106] por edhe i shpallën marrëveshjet me fqinjët si "instrument të tmerrshëm të gjenocidit kulturor dhe demaqedonizimit".[107] Mesazhet etnocentrike të Kocarevit si akademik u përhapën nga disa media edhe gjatë zgjedhjeve të vitit 2024, së bashku me dezinformatat se "qeveria, për të filluar negociatat për anëtarësim në BE, tashmë është pajtuar se maqedonasit nuk jetojnë dhe nuk kanë jetuar kurrë në Maqedoni."[108] Kocarevi edhe pas zgjedhjeve vazhdoi me narrativën etnocentrike të "demaqedonizimit",[109] e cila u ushqye në gazetën Nova Makedonija për të përhapur teori konspirative dhe dezinformata për Marrëveshjen e Prespës.[110] Një pjesë e narrativave frikësuese për "demaqedonizimin" sulmonte jo vetëm marrëveshjet e fqinjësisë me Greqinë dhe Bullgarinë, por edhe "Kornizën e Negociatave për Demaqedonizimin", e cila u prezantua si "Gozhda e fundit në arkivol për shkatërrimin përfundimtar të maqedonizmit".[111]

Padyshim, me narrativa të tilla frikësuese për "demaqedonizim", të ngjashme me narrativat kundër "bullgarizimit", "shqiptarizimit", "kosovarizimit", nxiten ndjenjat etnike dhe thellohet polarizimi etnik në Maqedoninë e Veriut.

*(autori është drejtues i hulumtimeve në Institutin për Media dhe Analitikë IMA)*

## Referencat dhe burimet

1 Shih, për shembull, Krzhalovski: Polarizimi është një nga problemet më të mëdha në vend, të mos hyjmë në istikame partiake, ima.mk, 22.06.2023.

2 Shih: Saraçini: Duhet një trajtim më konsistent dhe efektiv i dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes që prish marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve, ima.mk, 16.05.2023: " IMA, përmes monitorimeve dhe analizave që ka bërë vitin e kaluar, konstatuan më shumë raste - veçanërisht për tema me kontekst ndëretnik, por edhe tema të tjera që polarizojnë dhe përkeqësojnë marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve - konstaton disa aktorë, aktorë të ndryshëm, të cilët nxisin ndarjet dhe polarizimin, urrejtjen dhe konfliktet ndërmjet komuniteteve, të cilat shpeshherë përshkallëzohen në dhunë".

3 Shih, Zharko Trajanoski, Në fokus të mediave: Institucionet demokratike, sundimi i ligjit dhe reformat në administratën publike - Raport nga monitorimi i mediave në temat "Institucionet demokratike", "sundimi i ligjit" dhe "Reforma e administratës publike", ima.mk, Shkup, tetor 2023, f. 29: "Polarizimi mbi baza etnike para debatit për ndryshimet kushtetuese ishte i dukshëm pas ringjalljes propagandistike të miteve etno-nacionaliste për "Bullgarinë e Madhe", pas përkujtimit të Mara Bunevës në janar 2023, pas gjuhës së urrejtjes dhe dhunës nga urrejtja ndaj përfaqësuesve të klubeve bullgare, pas festimit të ditëlindjes dhe vdekjes së Goce Dellçevit, pas ndeshjes Shkupi-Levski në Shkup etj. Ringjallja propagandistike e mitit etno-nacionalist të "Shqipërisë së Madhe" (sidomos nga propaganda ruse në Serbi), ishte e dukshme pas vizitës së kryeministrit të Kosovës Albin Kurti në Shkup dhe Tetovë, e cila u përdor për polarizim etno-politik nga partitë pro-ruse dhe mediat në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

4 Shih, Zharko Trajanoski, Teoritë konspirative për "bullgarizim" dhe dezinformatat për gjuhën dhe historinë maqedonase në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese , ima.mk, 02.10.2023: " Qëndrimi jokritik i mediave ndaj teorive konspirative "bullgarizim", dhe narrativave dezinformuese për popullin dhe gjuhën maqedonase, për historinë dhe identitetin, kontribuuan në rritjen e polarizimit shoqëror dhe forcimin e ndikimit malinj të aktorëve të huaj në hapësirën mediatike maqedonase".

5 Shih panelin e IMA-s për amendamentet kushtetuese: Beteja mediatike kundër dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes është betejë për audiencën, ima.mk, 29.09.2023: " Sipas Trajanoskit, emëruesi i përbashkët i të gjitha këtyre narrativave propagandistike është se ato dërgojnë porosi frikësuese dhe kërcënuese drejtuar kryesisht maqedonasve etnikë – porosi se ndryshimet e propozuara kushtetuese kërcënojnë mbijetesën e maqedonasve dhe popullit maqedonas, se kërcënojnë gjuhën maqedonase, identitetin maqedonas, historinë maqedonase, si dhe mbijetesën e shtetit".

6 Shih: RAPORTI PRELIMINAR 20 Mars – 4 Prill 2024, 9 Prill 2024: "Ndërsa mjedisi politik parazgjedhor ishte i qëndrueshëm, zgjedhjet po zhvillohen në një kontekst të karakterizuar nga polarizim i theksuar përgjatë vijave politike dhe etnike. Kjo ka penguar zbatimin e reformave legjislative, duke përfshirë reformat e planifikuara prej kohësh në Kodin Zgjedhor dhe legjislacionin përkatës, si dhe ato të kërkuara nga Bashkimi Evropian (BE) për anëtarësim."

7 Shih: MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIM TË ZGJEDHJEVE Republika e Maqedonisë së Veriut – Zgjedhjet Parlamentare dhe Raundi i Dytë i Zgjedhjeve Presidenciale, 8 maj 2024 , DEKLARATA E GJETJEVE DHE PËRFUNDIMEVE PARAPRAKE, ku një fusnotë liston disa shembuj: "Për shembull, profili në Fejsbuk i partisë E Majta (Levica) më 7 prill ndau një mesazh duke thënë se "është koha për t'i dhënë fund ndikimit të BDI-së dhe shqiptarizimit të Maqedonisë". Më 18 prill në profilin e liderit të partisë E Majta në Fejsbuk është publikuar mesazhi i mëposhtëm: "Bullgarët në Kushtetutë është tradhti, sot fillon pushtimi fashist bullgar i Maqedonisë". Më 29 prill, lideri i së Majtës shpalli një program politik që bën thirrje që zyrtarët shtetërorë të jenë maqedonas etnikë dhe për shfuqizimin e partive politike të organizuara në bazë të përkatësisë etnike. Politikanët e BDI-së shprehën publikisht interpretimin e tyre se slogani i VMRO-DPMNE-së "Maqedonia përsëri e jotja" është shoviniste dhe antishqiptare.

8 Shih urimin nga Bačevi me rastin e Fjetjes së Shën Marisë: Shtëpia, familja dhe Maqedonia janë shenjtëri dhe për këtë arsye beteja për shenjtërit tona është detyrë e shenjtë, edinstvenamakedonija.mk, 28.08.2022.

9 Shih, për shembull, TMRO: Është e qartë pse ASHAM nuk reagon ndaj BAN-it, nga 40 akademikë - 17 janë maqedonas etnikë, 12.12.2019: "Marrja e heshtur e institucioneve kyçe shtetërore nga pakicat, e cila ka vazhduar me dekada, ka bërë që maqedonasit të jenë qytetarë të rendit të dytë në vendin e tyre".

10 Shih, për shembull, Eftim Kletnikov, "Shqiptarët dhe Zezakët. Taravari dhe Obama", Nova Makedonija, 28.02.2024: "Shqiptarët në Maqedoni nuk janë qytetarë të dorës së dytë, por pas vitit 2001 janë qytetarë të dorës së parë me Marrëveshjen e Ohrit, ndarjen territoriale dhe Platformën e Tiranës, dhe maqedonasit dalëngadalë u bënë qytetarë rendit të dytë në shtetin e vet kombëtar"

11 Postimi i Hristijan Mickoski në Fejsbuk, 07.03.2019: "Sot, kudo që të ecësh, me këdo që të flasësh, ndonjë maqedonas etnik në Maqedoni, ndjenja mbizotëruese është se maqedonasit janë praktikisht qytetarë të rendit të dytë në vendin e tyre".

12 Shih: Mickoski nga Vevçani: Me vendosjen e taksës së solidaritetit, qeveria nuk është fer ndaj atyre që paguajnë taksat rregullisht, nuk guxon të ketë qytetarë të privilegjuar, mia.mk, 28.07.2023: "Këtu në Vevçan kemi rreth 2500 banorë, arkëtimi është më shumë se 98 për qind e energjisë elektrike, supozoj se e tillë është edhe mbledhja e taksave. Tani, pse këta në Vevçan të jenë qytetarë të rendit të dytë, e këta nga Sllupçani të jenë të privilegjuar. A duhet të hedhin në erë transformatorët e EVN-së apo të bëjnë diçka tjetër për të tërhequr vëmendjen? A duhet ta bëjnë ata ashtu siç bëjnë bashkëqytetarët e tyre në Sllupçan?"

13 Shih: Sulmi ndaj BDI-së nuk është kurrë sulm ndaj shqiptarëve, por ndaj krimit që ata përfaqësojnë, pohon Mickoski, Republika, 30.03.2024 dhe Mickoski: T'ia kthejmë Maqedoninë popullit - Maqedonia është e juaja dhe ndryshimet varen nga secili prej jush, vmro-dpmne.org.mk, 30.03.2024: "Jam i vetëdijshëm se atë që nuk mund ta bënin me pushkë, tani

duan ta bëjnë nga brenda, nga institucionet. Qëllimi i tyre është një, dhe ai është grabitja, shkatërrimi, poshtërimi dhe turpërimi i Maqedonisë. Për të poshtëruar ata që mbrojtën Maqedoninë. Kjo është një zgjedhje se kur duhet t'i kundërvihesh. Në këto zgjedhje populli duhet të dalë masovikisht dhe të votojë. Fillimisht do t'i dërgojmë në opozitë dhe pastaj ju garantoj dhe ju jap fjalën që ata do të përgjigjen për çdo lot, për çdo lot të derdhur nga një nënë, gjyshe, motër, për fëmijën që u largua nga Maqedonia sepse janë ndjerë si i qytetar i rendit të dytë, sepse dikush ua vodhi të ardhmen".

14 Shih, për shembull, Mickoski: Kovaçevski ia dha shtetin BDI-së, Makfax, 04.04.2024: "E rrënuan shtetin, nuk ka më sistem, nuk ka shtet, maqedonasit janë qytetarë të rendit të dytë, dhe jo vetëm maqedonasit. Qytetarë të rendit të dytë janë të gjithë qytetarët e tjerë pa dallim etnie, qofshin ata shqiptarë, turq, romë, vlleh, serbë, boshnjakë, të gjithë nga ky vend që nuk janë Artani, apo miqtë e tij, që nuk janë Bujari apo miqtë e tij, që nuk janë Zeçeviq, Mariçiq, Ali Ahmeti dhe Dimitar Kovaçevski dhe 100 grabitësit e tyre që e shkatërruan Maqedoninë tonë, të gjithë përveç tyre janë qytetarë të rendit të dytë", theksoi Mickoski.

15 Shih, p.sh., "TA FSHIJMË REGJISTRIMIN PËR RAUNDIN E DYTË QË ASKUSH TË MUND TË SHANTAZHOJË" Mickoski i bëri thirrje LSDM-së dhe Pendarovskit që bashkërisht ta bëjnë këtë ndryshim kushtetues, Plusinfo, 14.04.2024: "Populli po e kthen Maqedoninë pas këtyre zgjedhjeve. E kriminelëve, nuk mund t'u them për të gjithë, por atyre disave në krye të BDI-së, po u them se me 8 maj merr fund Maqedonia si shtet në të cilin do të jeni qytetarë të rendit të parë dhe të gjithë qytetarët e tjerë të rendit të dytë. Tani duhet të përgjigjeni për gjithçka që i bëtë Maqedonisë".

16 Shih, për shembull Mickoski: Premtuan drejtësi, por sollën një regjim artanoid, Fokus, 23.04.2024: "Ndjej se këtë herë populli është i vendosur të bashkohet për të dalë masovikisht, për të rrethuar numrin 2 dhe për të përmbysur me stilolaps këtë të ashtuquajtur regjim artanoid, dhe mund t'ju premtoj se gjithë padrejtësia që keni ndjerë këto 6-7 vjet e gjysmë, gjithë pafuqia, të gjitha disfatat, gjithë grabitja, poshtërimi dhe turpi që keni ndjerë. këto 6-7 vite e gjysmë dhe që ndiheshit si qytetarë të dorës së dytë në vendin tuaj, ne si qeveri do ta korrigjojmë dhe kriminelët dhe njerëzit që e bënë do të dalin para drejtësisë".

17 Shih, për shembull, NE NUK DO TË JEMI QYTETARË TË RENDIT TË DYTË! Mickoski paralajmëroi një fushatë pozitive që do të kthejë besimin e qytetarëve, Plusinfo, 18.04.2024: " Përveç disa nga BDI-ja dhe disa shërbëtorë nga lidershipi i LSDM-së, të gjithë qytetarët e tjerë kanë ndjenjën se janë qytetarë të rendit të dytë."

18 Me përparimin e fushatës, Mickoski dhe VMRO-DPMNE u përpoqën t'i japin kësaj narrative një dimension "qytetar". Shih, për shembull, Mickoski: Mbizotëron ndjenja dhe trajtimi i qeverisë ndaj njerëzve të rendit të parë dhe të dytë, vala është e madhe, pres që të arrijmë ose të vijmë afër 61 deputetëve, Kurir, 06.05.2024.: "Njerëzit e ndjejnë se ne kemi pak që janë të privilegjuar dhe qytetarët të rendit të parë, dhe shumicë të qytetarëve të rendit të dytë, dhe prandaj nuk habitemi nga ky numër në këto zgjedhje, dhe nëse pas raundit të dytë rritet në më shumë se 550.000 ose 600.000. vota, nuk do të habitesha nëse VMRO-DPMNE do fitonte 61 deputetë ose do të ishte afër."

19 Shih, për shembull Murat Aliu, A do të sjellin zgjedhjet historike një të ardhme më të mirë?, Respublika, 17.05.2024: "Një rrëfim i tillë i VMRO-DPMNE-së dhe liderit të tyre krijon bindjen tek qytetarët maqedonas se LSDM-ja ia ka dorëzuar shtetin BDI-së, e në nëntekst shqiptarëve. Gjatë gjithë kësaj kohe, motoja kryesore e VMRO-DPMNE-së ishte se LSDM-ja u shndërrua në "shërbëtor" të BDI-së. Sipas VMRO-DPMNE-së, maqedonasit kanë filluar të ndjehen si qytetarë të dorës së dytë në vendin e tyre. Ky rrëfim në mënyrë të pashmangshme rriti ndjenjën nacionaliste tek qytetarët maqedonas, veçanërisht në qarqet konservatore".

20 Shih, Lupço Popovski, 5 konkluzionet për rezultatet e papritura të zgjedhjeve, DW, 27.04.2024: "Kur me muaj, madje edhe një vit të tërë, Hristijan Mickoski dhe krerët partiakë të VMRO-së sulmuan BDI-në me të gjitha armët, kryesisht me akuza për krim dhe zotërim të shtetit, kjo në mënyrë implicite ushqeu ndjenjat nacionaliste te maqedonasit, veçanërisht me shprehjen se ata janë "qytetarë të rendit të dytë".

21 (Video) Vankovska: Maqedonia është gjithçka që nuk kemi, prioriteti i parë - ndërprerja e Marrëveshjes së ashtuquajtur për fqinjësi të mirë me Bullgarinë, Triling, 19.04.2024: "Ka synim për të etiketuar fjalën nacionalizëm si diçka të dëmshme. Fatkeqësisht, në këtë botë, mendoj se nacionalizmi maqedonas është në

defensivë, ne bëhemi qytetarë të rendit të dytë në vendin tonë, sepse dikush na bën një kompleks se jemi tejet nacionalistë. Maqedonia është gjithçka që nuk kemi".

22 Shih edhe (Video) Vankovska: Pse nacionalizmi maqedonas etiketohet si diçka e keqe?!, levica.mk.

23 Shih: Kushtetutë qytetare moderne për një popull dinjitoz, paralajmëroi Biljana Vankovska nga Kumanova, Kumanovo news, 12.04.2024: "Sepse kështu, siç kanë shkuar gjërat, Maqedonia është gjithçka që nuk e kemi. E kanë fshirë, ne ndihemi qytetarë të rendit të dytë në vendin tonë". Shih edhe Biljana Vankovska në Tetovë prezantoi programin " Po ia kthejmë dinjitetin kombit", Tetovo info, 04.07.2024: "... vend në të cilin maqedonasit ndihen si qytetarë të rendit të dytë. Na morën vendin. Nuk ka më demos, ka vetëm etnos".

24 Shih: Vankovska: Tri marrëveshjet ndërkombëtare janë të dëmshme për shtetin, RTMV, 09.04.2024.

25 Shih, Dimitar Apasiev (Fejsbuk), "Të shterim radhët e tyre me forcën e KARAKTERIT tonë", 05.03.2024 dhe Fjalim i kryetarit të partisë E Majta, prof. Dimitar APASIEV para zgjedhjeve kyçe parlamentare 2024 , FB Levica, 05.03.2024.

26 Shih: (Video) Dimitrievski: Te maqedonasit është krijuar ndjenja se janë qytetarë të rendit të dytë, për më shumë se 20 vjet po ndodh DUI-zim, Triling, 19.04.2024: "Elita politike që është në pushtet manipulon me marrëdhëniet etnike, në mesin e maqedonasve është krijuar ndjenja si qytetarë të rendit të dytë. Janë të frustruar, për më shumë se 20 vjet kemi një DUI-zim klasik, partner të përhershëm në qeveri." Shih edhe Dimitrievski: Duhet të bëjmë detyrat e shtëpisë, të kemi një vend me ekonomi të fuqishme, institucione të besueshme , PressingTV, 24.03.2024: "Është koha që bota zi dhe gri të zhduket nga Maqedonia. Ata i sollën maqedonasit që të ndjehen në vendin e tyre si qytetarë të rendit të dytë, duke imponuar një narrativë se Maqedonia është një vend bietnik, një vend me dy shumica dhe më shumë pakica".

27 Shih: "MAQEDONËT U BËNË QYTETARË TË RENDIT TË DYTË NË SHTETIN E TYRE", Veçer, 16.02.2024.

28 Shih: Dimitrievski nga Prilepi: Nuk do të lejoj që maqedonasit të jenë qytetarë të rendit të dytë në vendin e tyre, mediapress.mk, 15.04.2024.

29 Shih: Problemi më i madh janë ata që populli i ka zgjedhur vazhdimisht për 30 vjet, tha Maksim Dimitrievski, mms.mk, 20.04.2024: "Ne duhet të jemi pronarë në vendin tonë dhe të jemi si të tjerët në këtë vend, qytetarë të rendit të parë... këtë shtet e ka bërë populli maqedonas. Dhe prandaj duhet të ngrihet maqedonasi, të marrë guximin të thotë - Mjaft!".

30 Shih, për shembull, Grubi: Tezat e VMRO-DPMNE-së se Ahmeti është pronar i shtetit janë të pasakta, Sllobodeen Peçat, 09.04.2024: "Tezat e VMRO-DPMNE-së se BDI dikton dhe se maqedonasit janë qytetarë të rendit të dytë janë e pasaktë."

31 Shih: Ahmeti: Ka ende paragjykime te komuniteti maqedonas, me avancimin e shqiptarëve mendojnë se do t'u merret shteti, TV21, 22.04.2024: "Ka ende paragjykime te komuniteti maqedonas, komuniteti më i madh. Çdo avancim i shqiptarëve dhe i komuniteteve më të vogla si turqit, boshnjakët, romët, ndjehet shqetësimi se do t'u merret shteti, gjë që nuk është kështu. Marrëveshja e Ohrit, të drejtat e komuniteteve që i kanë fituar vetëm e forcon shtetin, e konkretizon shtetin sepse rritet lojaliteti i qytetarëve ndaj shtetit".

32 Shih, për shembull Osmani: Mickoski arriti të rikthejë një kujtim te shqiptarët për robërinë dhe nënshtrimin 100-vjeçar, Lokalno, 29.04.2024: "Ku do ta çojmë shtetin nëse mendojmë se nëse kemi një ministër shqiptar apo kryeministër, shteti është i shqiptarëve? Nacionalizmi lind nacionalizmin, tha Osmani në konferencën për media me rastin e Ditës së Ministrisë së Punëve të Jashtme.

33 Shih: Ahmeti: Brohoritjet UÇK janë të natyrshme, pa UÇK-në nuk do të ishte Maqedonia e sotme ose nuk do të ekzistonte fare, TV21, 22.04.2024.

34 Shih: A po afrohet një krizë edhe para se të zhvillohen zgjedhjet?, Nezavisen, 29/04/2024 "Hristian, unë hyra në politikë si kryengritës dhe nuk do të largohem pa u dorëzuar, ta kuptojmë, populli më votoi për 22 vjet. Unë formova një front me partitë politike shqiptare, por e bëra këtë front të pathyeshëm duke përfshirë komunitetet që ju i përbuzni, si komunitetin turk, rom dhe boshnjak".

35 Shih, për shembull, Stojançe Angellov deri te Ali Ahmeti: Ngrite frenin me kohë!, mkd.mk, 08.06.2024: "Në tubimin e mbrëmshëm të BDI-së në qendër të Shkupit, ish-komandanti i UÇK-së dhe presidenti aktual i BDI-së. Ali Ahmeti i drejtoi një kërcënim të hapur dhe

të drejtpërdrejtë Hristijan Mickoskit, i cili u shoqërua me brohoritjet "UÇK, UÇK, UÇK...", të cilës iu bashkua edhe vetë Ahmeti duke thirrur me zë të lartë "UÇK, UÇK, UÇK...". Mendoj se duhet të kujtoj se çfarë emocionesh zgjon te maqedonasit kur përmendet UÇK-ja edhe atë në qendër të Shkupit, në vetë sheshin e Shkupit, derisa të pranishmit valëvitnin flamuj të panumërt shqiptarë dhe flamuj të UÇK-së, pa asnjë flamur të vetëm maqedonas. Prandaj, i them Ali Ahmetit të ketë kujdes me kërcënimet!"

36 Shihni se si komunikimi mes DPMNE-së dhe BDI-së u reduktua në "biskota, gurabi, krime, qumësht, UÇK ", Zëri i Amerikës, 23.04.2024, Aleksandar Nikollovski nga VMRO-DPMNE: "Ato kërcënime janë akt nervozizmi, por edhe kërcënime që thonë shumë për strukturën e Ali Ahmetit. Sa herë që i kapni për korrupsionin, thirren në UÇK-në. Sa herë që i kapni për korrupsion, bëjnë thirrje për luftë. Sa herë që u thua se do të përgjigjen, thonë se do të ndodhë belaja. Më lejoni t'u them nga këtu, nuk është 2001-ta, është 2024-ta, së pari. Së dyti, kjo udhëheqje e VMRO-DPMNE-së nuk është e njëjtë me atë të vitit 2001 dhe ne as nuk kemi frikë nga ju, as nuk do t'ju dorëzohemi, as do të ulemi në të njëjtën tavolinë me ju për të negociuar, e lëre më të vijmë në një marrëveshje".

37 Shih, Eroll Rizaov, Ju qofshin me fat plagët "heronj", DW, 21.05.2024: "...betejat parazgjedhore janë zhvendosur në terrenin e patriotizmit dhe temat e preferuara ndëretnike të qytetarëve të rendit të parë dhe të dytë. "Maqedonia sërish e jotja". UÇK, UÇK, UÇK... Tetova kryeqytet, brohoritje për kryeministrin e Kosovës Albin Kurti dhe militantë të ngjashëm si dhe shpërthimet nacionaliste".

38 Kovaçevski: Vota për VMRO-në sjell vetëm tensione ndëretnike, media të kapura, qytetarë të heshtur, studentë të rrahur, sdsm.org.mk, 28.04.2024: "Jam edhe më i sigurt se asnjë qytetar nuk dëshiron të kthehemi prapa më shumë se 20 vjet dhe sërish të ndizen tensionet ndëretnike. Por me sa duket VMRO-ja dhe BDI-ja janë të gatshme edhe për këtë vetëm për të mbledhur ndonjë votë politike politike plus".

39 Shih, Eroll Rizaov, A do të ofrojë Mickoski mbretëri për kalë?, DW, 04.06.2024: "Mbaroi rreziku nga vërshimi shqiptar, se maqedonasit janë qytetarë të rendit të dytë në shtetin e tyre. Tani kemi frikë nga cunami i kundërt, nga pakënaqësia shqiptare e fituesve të tyre në zgjedhjet që po e përgatisin Ali Ahmeti dhe BDI, siç thonë ata, kundër majorizimit të VMRO DPMNE-së dhe injorimit të përcaktimit elektoral të shqiptarëve".

40 Shih: Mickoski pas marrjes së mandatit: Me qeverinë e re reformuese nuk do të ketë qytetarë të rendit të parë dhe të dytë , Makfax, 06.06.2024: "Së shpejti do të formohet qeveria e re reformuese, e cila do t'i çojë proceset përpara. Qytetarët të ndjehen mirë, të mos ketë qytetarë të rendit të parë dhe të dytë..."

41 Shihni, për shembull, Zaev bën shqiptarizim brutal të organeve shtetërore me administratorë shqiptarë, edinstvenamakedonija.mk, 22.03.2018.

42 Sipas një kolumnë të publikuar në uebfaqen e "Rodinës", "LSDM-ja ka për detyrë të shkatërrojë Maqedoninë dhe maqedonasit" dhe "pason shqiptarizimi i plotë si intensifikim i spastrimit etnik me ndihmën e migrantëve që planifikojnë t'i popullzojnë, dhe për të cilët USAID kanë përgatitur plan dhe logjistikë." (Kolumnë në uebfaqen e "Rodina", 05.02.2019)

43 Shih, për shembull: SPM: Osmani duhet të largohet, të bëhen zgjedhje urgjente parlamentare, A1on, 15.02.2023: "Ministri aktual Bujar Osmani vazhdimisht vërteton se punon kundër interesave të Maqedonisë. Paraqitjet e tij janë jo bindëse, jo shtetërore dhe të pakuptimta. Ai avokon për shqiptarizimin e shtetit maqedonas dhe për njohjen dhe mbrojtjen e interesave të vendeve të tjera në suaza ndërkombëtare".

44 Shih, për shembull Gërçeva: Barbarët nga LSDM-BDI do ta "hanë" më 8.5, por duhet të dënohen për të gjitha veprat kundër Republikës së Maqedonisë dhe popullit maqedonas!, expres.mk, 27.02.2024: "Pasi u shfarosëm si maqedonas, LSDM e pangopur lejoi shqiptarizimin e plotë të shtetit, vetëm për të qëndruar në pushtet".

45 Shih, për shembull, Mickoski: Po ndodh DUIZIMI i sistemit - që na sjell duizimin e Maqedonisë, Kanal 5, 11.05.2023.

46 Shih, për shembull, VMRO-DPMNE: Me Talatin si kryeministër po ndodh DUI-zimi i plotë, Kanal 5, 09.12.2023: "LSDM dhe Dimitar Kovaçevski e shkatërruan plotësisht Maqedoninë... Maqedonia po DUI-zohet, dhe Kovaçevski është drejtpërdrejt përgjegjës për këtë."

47 Shih: Mickoski: Sulmi ndaj BDI-së nuk është kurrë sulm ndaj shqiptarëve, por sulm ndaj

krimit që ata përfaqësojnë dhe avokojnë, vmro-dpmne.org.mk, 30.03.2024.

48 Shih, për shembull, Gligor Stoimenov, ZGJIDHJE PËR MAQEDONINË, PAS 8 MAJIT, Libertas, 18.04.2024 , i cili konsideron se VMRO-DPMNE përfiton më së shumti politikisht nga frika e "shqiptarizimit" te maqedonasit etnikë: "Në fakt, nëse bëni një analizë të shkurtër mes qytetarëve, do të shihni se pakënaqësia dhe vota kryesore për të djathtën maqedonase dhe për VMRO-DPMNE-në, mbi të gjitha, do të rrjedhin pikërisht nga ajo "frikë" imagjinare e "shqiptarizimit" të Maqedonisë. Një numër i madh i maqedonasve janë të bindur për këtë dhe do të votojnë për VMRO-DPMNE-në, të gatshëm të sakrifikojnë edhe të ardhmen evropiane dhe demokracinë në vend, vetëm për t'u vënë rend shqiptarëve, sepse, apo jo, e kemi "humbur shtetin"."

49 Shih Qeveria vërhoviste-balliste legjitimon dhunën si një mjet për të shkatërruar protestat, Antropol, 22.07.2022.

50 Shih: Apasiev: Gjykata Kushtetuese është një vëzhgues memec i demaqedonizimit ballist të Maqedonisë, Antropol, 22.06.2023: "Në vend që Gjykata Kushtetuese të miratojë një zgjidhje të përkohshme që pezullon udhëzimin e diskutueshëm të ministrit ballist të drejtësisë, ajo është një vëzhgues memec i demaqedonizimit në kundërshtim me Kushtetutën. !" Ah Kacarska, Kacarska. Morr i regjimit!", ka shkruar Apasiev në profilin e tij në Fejsbuk.

51 Shih, Ismail: Kërkesat vetëm për do farë komunash shqiptare vetë në rrugën drejt BE-së janë ringjallje balliste!, 18.08.2023.

52 Shih, p.sh., Me 750 amendamente, Levica bllokon shqiptarizimin kontrabandues të Avokaturës Shtetërore, Antropol, 13.02.2024: "E Majta nuk njeh miratimin me dhunë dhe kontrabandues e të ashtuquajturit "Ligj për përdorimin e gjuhëve" të shpallur pa nënshkrimin e Presidentit të Republikës dhe me amendamentet e hedhura të opozitës dhe çdo dakordim me të e konsideron të paligjshëm dhe është e gatshme ta parandalojë me të gjitha mjetet demokratike që kemi në dispozicion!".

53 Shih: "Bashkëjetesa në Tetovë: Mes frikës së harmonisë së humbur dhe pritjeve për të nesërme më të mirë", Antropol, 30.04.2024, ku kandidati për deputet nga E Majta flet kundër "kryetarit neoballist Kasami, i cili punon ekskluzivisht kundër popullsisë dhe kauzës maqedonase".

54 Shih: Mojsoska: Agjenda e Kasamit është totalisht neoballiste dhe ka për qëllim rrënimin e ASNOM-it, Antropol, 19.03.2024: "...Agjenda e Kasamit është tërësisht NEOBALLISTE dhe ka për qëllim rrënimin e themeleve antifashiste të ASNOM-it. Ndërsa DPMNE si partner koalicioni në Tetovë HESHT para mohimit të hapur të viktimave në luftën antifashiste. Dhe po, bashkëjetesë me ballistet nuk ka dhe nuk do të ketë kurrë!" dhe Maksim dhe Znam nuk dinë asgjë për monumentin ballist në Voinoviq, Antropol, 21.03.2024: "A do të veprojë kësaj radhe kryebashkiaku Maksim Dimitrievski në përputhje me ligjet dhe të rrënojë ndërtimin pa leje ballist në Kumanovë ose do të vazhdojë me parimin e tij të qeverisjes - NUK DI asgjë, thanë nga E Majta".

55 Shih Ismail: Turqit maqedonas nuk do të manipulohen nga munafikllëku, Antropol, 31.03.2024: "Binacionaliteti si motor politik i shqiptarëve në Maqedoni ka krijuar kushte, në të cilat po zhduken në heshtje, pra po shqiptarizohen (ose më saktë, kosovarizohen) të gjitha bashkësitë më të vogla të kombësive - e komuniteti më i prekur nga kjo është sigurisht komuniteti turk".

56 Shih në Instagram, Levica, 23.04.2024.

57 Shih E Majta: Platforma maqedonase që të ndalojmë shantazhet nga partitë neo-balliste, Antropol, 29.04 2024; Apasiev: Platforma maqedonase për të ndalur shantazhet e ballistëve, Antropol, 30.04.2024.

58 Apasiev: E Majta do të bëjë koalicion me qeveri që do të pranojë vijat e kuqe në mbrojtje të shtetit maqedonas, Makfax, 29 prill 2024: "Keni tre platforma. Platforma e parë është Platforma e Tiranës, pas së cilës qëndrojnë parti neoballiste të pakicës shqiptare, pavarësisht nëse është BDI, apo është koalicioni VLEN - është i njëjti koncept, që çon në shpërbërjen e shtetit".

59 Shih: Apasiev nga Manastiri: Mes Platformës së Tiranës të partive shqiptare dhe platformës së Sofjes të LSDM-së dhe DPMNE-së, do të fitojë platforma jonë maqedonase, 365, 29.04.2024.

60 Shihni: Apasiev në Shtip, faqja e Të Majtës (Levica) në Fejsbuk, 2 maj 2024, video me mbi 500 mijë shikime.

61 Shih faqen e Dimitar Apasiev në Fejsbuk dhe Instagramin e partisë E Majta (Levica).

62 Shih: Ismail: NEGOCIATAT PËR QEVERI – Vëllazërim-bashkimi Vs. multikulturalizmit,

Antropol, 12.05.2024: "Sot, idetë e ballizmit janë bërë një lloj krenarie dhe tipar kryesor i mjedisit dhe kulturës shqiptare tek shqiptarët në Maqedoni".

63 Shih: E Majta: E përdhosur zemra me flamurin maqedonas në Gostivar, Antropol, 22.05.2024.

64 VIDEO INTERVISTË | Dimitar Apasiev, E Majta: Historia po përsëritet, e para nesh është ndarja ideologjike e partizanëve, vërhovistëve dhe ballistëve, Sllobodën Peçat, 23.05.2024: "VLEN" janë neoballistë dhe kjo është shumë e rrezikshme. Ata janë haptazi me hartat e "Shqipërisë së Madhe", shihni monumentet e atyre "therësve" në Gostivar, përdhosjen e monumenteve të flamurit maqedonas, e gjitha është vepër e tyre. Ata që po vijnë tani janë më të këqij, sepse nuk e ndjejnë se vendi është i tyre".

65 Shih, për shembull, Apasiev: E Majta nuk do të mbështesë që një shqiptar të jetë kryetar i Kuvendit, Alsat-M, 28.05.2024: "Ne do të jepnim mbështetje e gjashtë deputetëve tonë që të mos bëhet një shqiptar kryetar i Kuvendit. I bëjmë thirrje hapur Mickoskit, me mbështetje të pakusht, vetëm që të mos kosovarizohet përsëri Kuvendi i Maqedonisë". Videoja nga TV Sitell "Apasiev: E mbështesim Mickoskin, vetëm të mos lejojë kosovarizimin e Kuvendit të Maqedonisë" është shikuar gjerësisht në Youtube dhe Tik-Tok.

66 Shih, p.sh.: Afrim Gashi i zgjedhur kryeparlamentar i ri - 76 deputetë votuan "PËR", kundër E Majta, LSDM nuk votuan, e BDI mungoi, Telma, 28.05.2024: "Nuk kemi problem që Afrim Gashi është shqiptar. Ne kemi problem se është "neoballist" dhe është "maqedonofob".

67 Shih: Mojsoska: Platforma e Tiranës u mbindërtua në platformë KOSOVARE, Antropol, 28.05.2024: "Sot e mbindërtuam Platformën e Tiranës me platformën KOSOVARE, kështu që irredentistët që pritën Kurtin me flamujt e Shqipërisë së madhe, fituan njeriun e dytë të shtetit. Neoballistët e BDI-së i zëvendësuam me neoballistët e VLEN-it dhe në vend që t'i "puthë dorë" Edi Ramës, kryesia e shtetit do të shkojë t'i "puthë dorën" Kurtit".

68 Shih, Instagram, Levica, 01.06.2024: "Ne ju ofruam një platformë maqedonase e ju zgjodhët platformën e Tiranës."

69 Shih: Maqedonisë së Veriut i kanoset "kosovizimi", Politika, 30.05.2024: "Nuk duhet të harrohet fakti që koalicioni "VLEN", kandidat për president i të cilit ishte Dr. Arben Taravari, konsultohej rregullisht me Albin Kurtin. I njëjti koalicion e shpalli Kurtin president i të gjithë shqiptarëve në Tetovë dhe ishte për emërtimin e një pjese të rrugës në Shkup për nder të Adem Demaçit, ideologut e të ashtuquajturës Republika e Kosovës dhe "Shqipërisë së Madhe", rrugën e të cilit po përpiqet të vazhdojë Kurti".

70 Shih: E Majta: DPMNE hip në fron dygjuhësinë antikushtetuese, Antropol, 29/05/2024: " Në frymën e kurorëzimit të neoballistit, ish-kryetari i partisë politike Alternativa, Afrim GASHI, kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, shtrohet një pyetje shumë legjitime: A vazhdon DPMNE agjendën shqiptaromadhe të partnerëve të rinj të koalicionit?"

71 Narrativa të tilla dezinformuese, nxitëse dhe polarizuese, të cilat përfshinin kërcënime imagjinare jo vetëm ndaj identitetit maqedonas, por edhe ndaj popullit maqedonas, sipas ekspertëve për dezinformata të BE-së, ishin thelbësore për "minimin e pjesëmarrjes në referendumin për ndryshimin e emrit". Shih: Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying Ways to Effectively Counter Them, Policy Department for External Relations Directorate General for External Policies of the Union, February 2021 p. 30.

72 Shih, Zharko Trajanoski, "DEZINFORMATAT, MANIPULIMET MEDIATIKE DHE TEORITË E KONSPIRACIONIT RRETH 'PROPOZIMIT FRANCEZ' në Propozimi Francez": Gjuhë e urrejtjes, dezinformata, manipulime mediatike (analiza mediatike), IMA, 2022.

73 Shih: Zharko Trajanoski, Narrativa për amendamentet kushtetuese: Ringjallja e dezinformatave të vjetra dhe teorive të konspiracionit për "gjenocid" dhe "etnocid" të popullit maqedonas, ima.mk, 14.09.2023.

74 Shih, Zharko Trajanoski, Teoritë konspirative për "bullgarizim" dhe dezinformatat për gjuhën dhe historinë maqedonase në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese, IMA, 02.10.2023: " Qëndrimi jokritik i mediave ndaj teorive konspirative për "bullgarizim" dhe narrativave dezinformuese për popullin dhe gjuhën maqedonase, për historinë dhe identitetin, kontribuan në rritjen e polarizimit shoqëror dhe forcimin e ndikimit malinj të aktorëve të huaj në hapësirën mediatike maqedonase."

75 Shih Lupço Popovski, 5 konkluzione për rezultatet e papritura të zgjedhjeve, DW, 27.04.2024: "E djathta Patriotike" vërshoi narrativën me mesazhe se "Marrëveshja e Prespës, Marrëveshja me Bullgarinë dhe propozimi francez janë fatkeqësi për Maqedoninë, një tradhti ndaj popullit maqedonas, rrënjëve të tij historike, luftës së tij shekullore, të kaluarës krenare".

76 Shih, p.sh. "NË FOKUS" - Frytet e shtatë viteve të LSDM-së dhe BDI-së: Propozimi francez i pranuar kundër vullnetit të maqedonasve!, Alfa, 12.03.2024, ku pretendohet se "Përveç vetë propozimit francez, Maqedonia pranoi edhe dy protokolle, të gjitha sipas shijes së Bullgarisë, e në dëm të Maqedonisë".

77 Shih, për shembull, Sasho Tanevski, A duhet Sofja të krijojë diskursin social maqedonas në parazgjedhoret?!, Maqedonia e Re, 08.03.2024.

78 Shih, për shembull: Mickoski: Me "propozimin francez" qeveria poshtëroi qytetarët e Maqedonisë, Fokus, 04.03.2024 dhe KUJT I ËSHTË ËSHTË "PRERË BARKU" DHE KUSH ËSHTË I PAVENDOSUR, Kovaçevski dhe Mickoski hynë në përplasje për propozimin francez, Plusinfo, 04.03.2024, Mickoski: "... jo vetëm që e poshtëruan Maqedoninë dhe jo vetëm që e vunë në pozitë të nënshtruar, por edhe u përpoqën të manipulojnë me vetëdijen dhe inteligjencën e qytetarëve, duke i parë në sy e duke i gënjyer, dhe sikur po punonin me vetëdije për interesat e Bullgarisë dhe tani e bllokuan rrugën integruese evropiane Maqedonisë".

79 Shih: KËTO NUK JANË ZGJEDHJE PËR EVROPË APO PËR IZOLIM Kjo qeverisje e ka larguar Maqedoninë nga BE-ja, akuzoi Mickoski, Plusinfo, 11.03.2024: " Edhe kjo e fundit që u nënshkrua dhe u quajt propozimi francez, është gënjeshtër madje gënjeshtër e madhe se praktikisht është një marrëveshje për anëtarësim në BE. Kjo është një marrëveshje që do të hapë më tej procesin e kushteve shtesë dhe do ta bëjë të pamundur vetë rrugën për Maqedoninë dhe qytetarët maqedonas".

80 Shih, për shembull, Siljanovskën në Instagram me mesazhin "Pendarovski tha se propozimi francez duhet të refuzohet, por nuk i është përmbajtur kësaj!".

81 Shih: Platforma Maqedonia përsëri krenare, f. 10 dhe f.16.

82 Shih: "Samo Intervju" (Vetëm intervistë) me Maksim Dimitrievskin 14.03.2024, pjesa 2: "Në pjesën e kornizës negociuese dhe në të gjithë përmbajtjen e "propozimit francez" ju keni thelbin e rezolutës bullgare që u miratua nga parlamenti bullgar, ku ne jemi të mohuar si popull, komb, gjuhë, identitet, vazhdimësi. Dhe kjo nuk duhet të jetë absolutisht e pranueshme – Pse? Sepse maqedonasi nuk duhet t'ia lejojë vetes të mohojë vetveten dhe të shkatërrojë veten". Shih, gjithashtu: Propozimi francez nuk përmban rezolutën negative bullgare, Vistinomer, 15.03.2024.

83 Shih: DPMNE në koalicion me një parti që tashmë ka pranuar propozimin francez, Antropol, 29/03/2024.

84 Shih (INTERVISTA) Vankovska: Do të doja të isha kryetare e popullit - nga populli për popullin!, Fokus, 19.04.2024: "Propozimi francez erdhi si rezultat i pakurrizorëve në qeverinë maqedonase»... ne nuk kemi filluar negociatat, e këtë e fitoi edhe një Ukrainë e shkatërruar nga lufta, përfitimet luftarake, shembja e shtetit..."

85 Shih, Biljana Vankovska, "Po ia kthejmë dinjitetin kombit ", f. 13.

86 Shih: Vankovska: Marrëveshja e Prespës dhe Bullgarisë janë marrëveshje kolonizimi, Makfax, 28.03.2024

87 Vankovska: Edhe sikur ta ndryshojmë Kushtetutën, nuk do të na pranojnë kështu në BE, Libertas, 28.03.2024.

88 Shih, Zharko Trajanoski, Teoritë konspirative të "bullgarizimit" dhe dezinformatat për gjuhën dhe historinë maqedonase në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese, ima.mk, 02.10.2023: "Narrativat dezinformuese që përmbajnë teori konspirative për «bullgarizim» u përhapën nga liderët e partisë më të madhe opozitare VMRO-DPMNE në kontekst të "propozimit francez" dhe hapjes së negociatave me BE-në. Pasi Kuvendi miratoi konkluzionet për «propozimin francez», Mickoski akuzoi për «tradhti, plani i së cilës është asimilimi dhe bullgarizimi i popullit maqedonas». Diskursi opozitar kundër "bullgarizimit" në kontekst të "propozimit francez" u forcua dhe u radikalizua edhe nga politikanët pro-rus".

89 Shih: Mickoski: Nuk do të ketë ndryshime kushtetuese nën diktat bullgar, Kanal 5, 04.03.2024, Mickoski ndaj Kovaçevskit: Të shikoj në sy dhe të them, nuk do të ketë ndryshime kushtetuese nën diktat bullgar, Kurir, 04 .03.2024 dhe Mickoski: Hyrja e bullgarëve në Kushtetutë është diktat i pranuar nga kjo

qeveri, nuk e shoh të nevojshme përfshirjen e bullgarëve që gëzojnë të gjitha të drejtat , vmro-dpmne.org.mk 22.04.2024.

90 Shih, për shembull, "VETËM VANKOVSKA DHE E MAJTA LUFTON KUNDËR BULLARIZIMIT TË MAQEDONISË" "Klubi fashist" në Manastir u mbyll me iniciativën e kësaj partie, kujton Mojsoska, Plusinfo, 08.04.2024: Bartësi i listës në NjZ5. Mojsoska: Qytetarët shohin se vetëm E Majta dhe vetëm profesoresha Vankovska janë kundër bullgarizimit të Kushtetutës.

91 Apasiev: Platforma maqedonase kundër kosovizimit dhe bullgarizimit, mkd.mk, 05.05.2024: "Numri më i madh i deputetëve të Së Majtës në Kuvend do të nënkuptonte digë kundër të gjitha politikave të dëmshme të kosovizim dhe bullgarizim të shtetit".

92 Shih Eroll Rizaov, A e njohët patriotin e vërtetë, DW, 12.03.2024: "Dhe së fundi, vazhdimisht kumbon një alarm i fortë për të shpëtuar Maqedoninë nga rreziku i humbjes së identitetit, gjuhës, shkrimit, historisë, rrezikut të asimilimit dhe bullgarizimit, rrezikut nga armiqtë e brendshëm dhe mercenarët e huaj, rrezik nga Evropa dyfytyrëshe dhe proteksioniste, rrezik nga Amerika dhe NATO, rrezik nga çdo gjë që mendon ndryshe nga patriotët suprem".

93 Shih, Lupço Cvetanovski, Stevo i quajtur minusi, Kurir, 25.04.2024: " Minusi i pariparueshëm prej 182.000 votash që të bëjnë kandidatin komunist më humbës me më pak vota të fituara në historinë e partisë sate antimaqedonase është rezultat i moskonzistencës tënde, i bullgarizimit stupid të Dellçevit, babait të kombit".

94 Shih, për shembull, Risto Nikovski, Kthesa kyçe, Plusinfo, 30.05.2024: " Më në fund, si mendoni - pse me vite ministri dhe zëvendësi i tij në MPJ - janë shqiptarë?" A janë ata, me ndihmën e "partnerëve tanë strategjikë", të ngritur atje për ta zgjidhur "çështjen maqedonase" në mënyrën më të lehtë, pa emocione? Për të lehtësuar bullgarizimin e maqedonasve, apo jo?"

95 Shih, për shembull, Dalibor Stankoviq, Marrëveshjet dypalëshe që shkatërrojnë Maqedoninë e pacenueshme, Nova Makedonija, 15.03.2024. Shih edhe Pande Kolemishevski, Cilat çështje dhe tema në fushata NUK do të sjellin vota?, Nova Maqedoni, 04/04/2024: " Propozimi francez, në vend që të përmirësonte, përkeqësoi marrëdhëniet me Bullgarinë... Propozimet e Makronit, në vend që t'i çimentonin ato, ringjallën dhe imponuan diskutimet e harruara historike për bullgarizimin dhe asimilimin dhe futën dyshime në brezat e rinj maqedonas".

96 Shih, për shembull, Igor Janev, Me marrëveshjen e Prespës identiteti ynë është ndryshuar përgjithmonë , Nova Makedonija, 04.06.2024: "Marrëveshja e Prespës është një marrëveshje asgjësuese që kryen asgjësimin kombëtar, e ai bullgar e anulon identitetin maqedonas dhe e përfshin në të vetin, e në fakt bëhet asimilimi. Ky është procesi i bullgarizimit. Nëse marrëveshja me Bullgarinë ndërpritet, ne do të shpëtojmë nga korniza franceze e negociatave, sepse baza e kësaj kornize është marrëveshja bullgare."

97 Shih: Bisedimet për Sovranitetin - Hijet e Globalizmit mbi Maqedoninë, Slloboden Svet, 14.03.2024.

98 Shih p.sh., DEMONSTRUESIT POROSITËN: Po bëhet demaqedonizimi i Maqedonisë, Faktor, 27.02.2018: "Po bëhet demaqedonizimi i Maqedonisë, është porositur sonte nga protesta për të mbrojtur emrin e Maqedonisë në Shkup".

99 Siljanovska – Davkova: Republika e Maqedonisë ndërmjet firomizimit, maqedonizimit dhe demaqedonizimit, expres.mk, 17.02.2018.

100 "Teza se me ndryshimin e emrit do të forcojmë identitetin kombëtar, në mungesë të mbiemrit "maqedonas" para institucioneve kombëtare, shtetërore dhe publike, të financuara nga shteti, është "mendim i dëshiruar"(wishfull thinking)! Në fakt, bëhet fjalë për denominim, shkombëtarizim (si demos) dhe demaqedonizim (si demos), gjë e panjohur në marrëdhëniet moderne ndërkombëtare dhe dypalëshe".

101 Shih: Siljanovska: Riemërtimi i institucioneve është demaqedonizim, drejtësia për Maqedoninë duhet të fitojë!, Netpress, 11.03.2019.

102 Shih, për shembull, Zaev zbaton demaqedonizimin përmes Georgievskit dhe Buçkovskit, shfuqizon departamentet e gjuhës maqedonase dhe letërsisë maqedonase, Netpress, 5.03.2021: " Zaev planifikon dhe zbaton demaqedonizimin e çdo gjëje maqedonase në Republikën e Maqedonisë. Thjesht, shpërfytyrim i identitetit, gjuhës, historisë, popullit, kombit, shtetit dhe gjithçkaje që na bën krenarë neve maqedonasve, theksoi

Dimçe Arsovski, zëdhënës i VMRO-DPMNE-së".
103 Shih: (Video) Apasiev: Po kryhet procesi i demaqedonizimit të Maqedonisë, Antropol, 07.04.2022: "Përmes këtij demaqedonizimi duan të na bëjnë kurdë në Ballkan. Le të jemi brutalisht të sinqertë. Zvicra, por Zvicra nuk ka zviceranë. Që ne të jemi Zvicra e Ballkanit, nuk duhet të ketë maqedonas".
104 Shihni për shembull faqen në Fejsbuk "Nuk e hap derën", 15.09.2021, ku publikohet video e paraqitjes mediatike të Apasievit në Kanal 5, me mesazhin "Ky është REGJISTRIM PËR FSHIRJEN e maqedonasve, regjistrim për demaqedonizim dhe regjistrim për kosovarizimin e Maqedonisë".
105 Shih: " Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Maqedonisë në vitin 2021 dhe sfidat e AHSAM dhe vendit në periudhën e ardhshme, e mbi të gjitha, në vitin 2022": "Me këtë veprim - festimi i 120 vjetorit të ASHAM, e cila është e obliguar t'i mbrojë dhe të kujdeset për shtyllat e popullit maqedonas - identitetin, gjuhën dhe kulturën maqedonase, institucionalisht do të dërgojmë, nëse asgjë tjetër, të paktën një mesazh simbolik se ne nuk jemi një komb pa rrënjë, që, për mendimin tim, veçanërisht në këto kushte, jo vetëm që është e drejtë e shenjtë, por edhe detyrë e shenjtë e ASHAM, që t'u rezistojë të gjitha përpjekjeve për demaqedonizimin e Maqedonisë".
106 Shih, për shembull, Kocarev: Ekziston rreziku i demaqedonizimit, Triling, 29.07.2022.
107 Shih Marrëveshjet e fqinjësisë me Greqinë dhe Bullgarinë janë një instrument i tmerrshëm për gjenocid kulturor dhe demaqedonizim, Nova Makedonija, 06.11.2023.
108 Shih "Poligraf": Kush dezinformon se Qeveria është pajtuar që maqedonasit nuk jetojnë dhe nuk kanë jetuar kurrë në Maqedoni?, ima.mk, 23.04.2024: " Më 4 prill 2024, e përjavshmja "Eho maqedonase" (Makedonsko eho) publikoi intervistë me akademikun dhe deri vonë kryetar i ASHAM, Lupço Kocarev, në të cilin konstaton se "Qeveria për të filluar negociatat për anëtarësim në BE, tashmë është pajtuar që maqedonasit nuk jetojnë dhe nuk kanë jetuar kurrë në Maqedoni". Për këtë pretendim, Kocarev merr parasysh marrëveshjet me Greqinë dhe Bullgarinë, si dhe kornizën negociuese si "dokument zyrtar të BE-së".
109 Lupço Kocarev, Thirrje për Rezistencë, Nova Makedonija, 23.05.2024: "Ajo që po ndodh me ne, maqedonasit, për shumë njerëz është gjenocid (kulturor, identitar), pavarësisht nëse do të ketë ndonjëherë ndonjë proces gjyqësor... vrasim vetë nipërit dhe fëmijët tanë, i vrasim në mbështetje të politikave për demaqedonizimin e mëtejshëm të Maqedonisë dhe krijimin e një "kombi laboratorik" të ri."
110 Shih: Manipulime të tmerrshme të Athinës me Marrëveshjen e Prespës , Nova Makedonija, 21.05.2024. Kocias për "Prespën": Me një marrëveshje fshiva një vend dhe një komb me gjithë historinë, traditën, kulturën dhe vlerat e tij!, Express , 21.05.2024. Shih edhe deklaratën e sajuar të Kocias për Marrëveshjen e Prespës është shpërndarë në rrjetet sociale, Vistinomer, 29.05.2024.
111 Shih, për shembull, Grozdan Cvetkovski, Dita e Marmotit, Fokus, 11.05.2024: "Gozhda e fundit në arkivol për shembjen përfundimtare të maqedonizmit u godit me pranimin e Marrëveshjes së Prespës për ndryshimin e emrit kushtetues, Marrëveshjes me Bullgarinë dhe Kornizës Negociuese për demaqedonizim."

# 2. FUSHATA PARAZGJEDHORE DHE MARRËDHËNIET NDËRETNIKE: FITORE E HIDHUR E NACIONALIZMIT

Shkruan: prof. MIRJANA MALESKA

Kur profesori amerikan i shkencave politike në Stenford, Francis Fukujama, shkroi në vitin 1991 se fundi i historisë kishte ardhur, ai nënkuptonte zhdukjen e ideologjisë dhe politikës së marksizmit dhe leninizmit nga skena evropiane dhe dominimin e demokracisë liberale. Frymëzim ishin revolucionet e vitit 1989 dhe rënia e Murit të Berlinit, me të cilin ndikimi perëndimor u përhap në Evropën Lindore dhe te ne.

Megjithatë, kur shikoj mjedisin politik në Maqedoni, veçanërisht gjatë zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare, do të thosha se korniza demokratike liberale nuk është e mbushur me asgjë tjetër veçse me nacionalizëm garues të të dy komuniteteve më të mëdha në vend, madje edhe kjo mund të vihet nën pikëpyetje. Nuk ka të djathtë, nuk ka të majtë, është bërë e pakuptimtë deklarata se për shqiptarët 'dielli lind në Perëndim'... Me qetësimin e euforisë parazgjedhore, nacionalizmi është varur përkohësisht në gozhdë si një strategji fituese e përdorur mirë prej sipërmarrësve të shkathtë politikë, derisa të nevojitet sërish. Fatmirësisht, sot jetojmë në një mjedis më stabil se në fillim të viteve të nëntëdhjeta dhe çdo problem i brendshëm politik pritet të zgjidhet me dialog.

Dallimin thelbësor midis të ashtuquajturave 'e majtë' dhe 'e djathtë'; atyre që tërheqin drejt integrimit të vendit në bashkimin e demokracive perëndimore dhe atyre që janë për status quo-në; mes atyre që qëndrojnë pas një programi dhe retorike nacionaliste dhe atyre që janë për një shoqëri të integruar - vështirë se do ta dalloni në proklamatat e tyre ideologjike, të cilat janë mjaft të ngjashme me njëra-tjetrën. Atë do ta gjeni në real politikë, që nga pavarësia e vendit në vitin 1991-tën e deri më sot.

Këto tridhjetë vjet kanë treguar se kush për çfarë qëndron dhe çfarë politike bën. "E majta" apo forcat politike për ndryshime demokratike, nëse përfshijmë kushtimisht LSDM-në dhe BDI-në në atë term, ndërmori disa hapa të rëndësishëm për stabilizimin e vendit dhe arritjen e synimeve strategjike të tij: zbatoi Marrëveshjen Kornizë të Ohrit (MKO); nënshkroi dhe miratoi Marrëveshjen e Prespës; nënshkroi Marrëveshjen e Miqësisë dhe Fqinjësisë së Mirë me Bullgarinë dhe të ashtuquajturin "Propozimi francez" me Brukselin. "E djathta nacionaliste" apo forcat politike të status quo-së, nëse në atë term para së gjithash e përfshijmë VMRO-DPMNE-në dhe partitë që gravitojnë rreth saj, kundërshtoi ndryshimet e kufijve komunalë dhe ligjin për përdorimin e gjuhës shqipe të dakorduar me MKO, dhe i bojkotoi marrëveshjet me Athinën, Sofjen dhe Brukselin, duke i shpallur të dëmshme, poshtëruese, pa kurriz dhe në kundërshtim me interesat kombëtare maqedonase.

Dallimi i dytë është në vizionin për integrim më të madh të komuniteteve dhe qytetarëve, i quajtur 'një shoqëri për të gjithë', i cili nuk ekziston në fushatën parazgjedhore dhe në programet e atyre që përbëjnë qeverinë e re. Thjesht është e fshirë, si gjëja më e parëndësishme, për arsye shumë logjike. Ideali i partive nacionaliste është një shoqëri etnikisht e pastër dhe ndarja sa më shumë e mundshme e bashkësive paralele. Jo rastësisht VMRO-DPMNE është parti e bashkimit kombëtar maqedonas dhe ideali i tyre është shtet kombëtar i popullit maqedonas, ndërsa koalicioni VLEN, p.sh., sipas deklaratës së

Bilall Kasamit për "360 gradë"[1], i përfaqëson interesat e pastra të shqiptarëve. Për të bërë dallimin, ai deklaroi se Fronti Europian ishte një koalicion në të cilin kishte edhe "të tjerë".

Izet Mexhiti, njëri nga liderët e VLEN-it, e ka shpjeguar edhe më qartë këtë dallim mes VLEN-it dhe BDI-së, në mbështetje të tezës se pse koalicioni i tij duhet të jetë pjesë e qeverisë. Ai në emisionin "Tema e ditës" në TV Sitell deklaroi se do të fitojnë votat e shqiptarëve dhe do të kenë "deputetë shqiptarë, që është "koncept i pastër shqiptar" dhe "kauzë" të tyre, ndërsa BDI nuk është përfaqësuese e shqiptarëve, sepse në koalicion ka parti turke, rome dhe boshnjake. Kjo, përsëriti Mexhiti, nuk është një ‹koncept i pastër shqiptar›.[2]

Në kontekst të narrativit të përforcuar nacionalist parazgjedhor, duhet shtuar se Bekim Qoku, me origjinë nga Struga, u bë deputet i koalicionit VLEN si përfaqësues i partisë së Albin Kurtit nga Kosova "Vetëvendosje". Kjo nuk është e parëndësishme, po të merret parasysh ngjashmëria e deklaratave të Nevzat Dervishit, njeriut që paralajmëroi themelimin e degës së "Vetëvendosjes" në Maqedoni, dhe programit të VLEN-it. Sipas portalit "Faktor", Dervishi vitin e kaluar ka thënë se kërkesa kryesore e tyre është "barazia në vendimmarrje" dhe "ndryshimi rrënjësor i sistemit politik për barazi të plotë mes maqedonasve dhe shqiptarëve". "Në një vend me dy bashkësi të mëdha etnike si Maqedonia e Veriut, formula e vetme është barazia në të gjitha nivelet shtetërore", tha Dervishi asokohe.[3]

Kështu, vendimet për të gjitha çështjet në nivel shtetëror do të merreshin me të ashtuquajturat "nënshkrime të lidhura", apo kundër-nënshkrim, dhe praktikisht çdo vendim mund të bllokohet nga përfaqësuesi politik shqiptar në qeveri, në të gjitha nivelet.

Kjo, rastësisht ose jo, është një nga kërkesat kryesore në programin parazgjedhor të VLEN-it, "një kushtetutë e re, më demokratike dhe më moderne, e cila do të ridefinojë vendin si shtet të barabartë të dy bashkësive shumicë".[4]

## Poenta nga platforma politike dhe zgjedhore e VMRO-DPMNE-së dhe partnerëve

Rezultatet treguan se qytetarët në zgjedhjet e fundit për kryetar të shtetit dhe deputetë në Parlament zgjodhën me masivitet opsionet nacionaliste. Këtë e kuptojnë dhe kjo është në zemrën e tyre! Kur është fjala për VMRO-DPMNE, vendi praktikisht i braktis ose i shtyn negociatat e anëtarësimit me BE-në dhe hyn në një periudhë izolimi ndërkombëtar. Zgjerimi i radhës i BE-së, i paralajmëruar nga komisari Oliver Varheji për vitin 2027, do lëshohet nga vendi për shkak të politikës, të cilën Hristijan Mickoski e përmblodhi në emisionin "*Samo Vistina*"(Vetëm e vërteta): "Nëse BE dhe Bullgaria vazhdojnë të na shantazhojnë, ne do të kthehemi kah problemet e brendshme, do t'i zgjidhim dhe do të presim të vijë një qeveri e re në Sofje".[5]

Këtë e përsërisin edhe zyrtarë të tjerë aktualë dhe ish-zyrtarë të lartë të kësaj partie, se nëse tregojmë rezultate të shpejta reformash në investime, sundimin e ligjit dhe luftë kundër korrupsionit, BE-ja, pavarësisht kundërshtimeve të Greqisë dhe Bullgarisë, do të jetë e impresionuar dhe do t'i hap dyert e saj për ne, e këtu janë edhe partitë e tyre simotra për të na ndihmuar (për shembull Milloshoski në "Top-Tema" në TV Telma nga 27.5.2024[6] ose Spasenovski në "Zaspij ako mozhesh" në TV Alfa më 28·5·2024[7]).

## Poenta nga platforma politike dhe elektorale e koalicionit VLEN

Nuk mund të flas shumë për ideologjinë e dy koalicioneve më të mëdha shqiptare, por po të krahasosh platformat e tyre elektorale dhe deklaratat e liderëve të tyre, është e qartë se BDI dhe Fronti Evropian mbeten të përkushtuar ndaj integrimit evropian të vendit dhe modelit konsocional të qeverisjes që përfaqëson një zgjidhje kushtetuese. Nga ana tjetër, koalicioni VLEN, i cili po ashtu i jep prioritet integrimit evropian, shkon më tej se rregullimi kushtetues konsocional dhe kërkon ndryshimin e Kushtetutës në drejtim të zgjerimit të të drejtave kolektive të komunitetit shqiptar në nivelin e vendimmarrjes së barabartë për të gjitha çështjet, që është karakteristikë e modelit federal.

Në platformën e shpallur zgjedhore, VLEN mori mbështetjen e votuesve shqiptarë për: një kushtetutë të re, më demokratike që do të ridefinojë vendin si shtet të barabartë të dy bashkësive shumicë dhe do të garantojë të drejta të plota edhe për komunitetet pakicë; gjuhën shqipe si gjuhë shtetërore e mbarë territorin e vendit, plotësisht e barabartë me maqedonishten; përdorimin e himnit kombëtar shqiptar, flamurit dhe stemës në shkolla dhe institucione me të drejta të barabarta ligjore si maqedonasit dhe krijimi i një këshilli kombëtar të diasporës shqiptare, në bashkëpunim me Kosovën dhe Shqipërinë.

Kjo është një platformë e ndarjes edhe më të madhe të komuniteteve, thënë shkurt, në drejtim të braktisjes së unitarizmit kushtetues të shtetit të vendosur nga MKO. Bilall Kasami e shpjegon këtë në emisionin "360 gradë": "K*oordinim me Shqipërinë dhe Kosovën për unifikimin e kurrikulave dhe teksteve shkollore në gjuhën shqipe, gjuhë, letërsi, histori, gjeografi, shoqëri, kulturë...*".

## Pasojat për demokracinë dhe bashkëjetesën

Një gazetar më pyeti, a është i mundur një koalicion "i panatyrshëm" mes dy koalicioneve nacionaliste? Unë iu përgjigja se është i mundur, nëse këto parti, gjegjësisht udhëheqësitë e tyre punojnë në mënyrë më pak transparente, e shumë më tepër "prapa dyerve të mbyllura", në ndarjen e komuniteteve, gjë që nuk duket shumë e mundshme për momentin, sepse programi i qeverisë rreth së cilit u dakorduan VMRO-DPMNE-ja dhe VLEN-i, veçon tre prioritete të përbashkëta: integrimin evropian, përmirësimin e ekonomisë dhe luftën kundër korrupsionit. Pjesa tjetër e çështjeve ndoshta do të vijë më vonë në rendin e ditës.

Vallë janë atëherë programet zgjedhore një mashtrim i thjeshtë? Unë mendoj se të gjitha opsionet mbahen të hapura. E vetmja për të cilën askush nuk interesohet, të paktën në fushatën zgjedhore, është integrimi më i madh i shoqërisë ose ‹një shoqëri për të gjithë›.

## Karakteri i qeverisjes së ardhshme

Që në programet parazgjedhore dhe në retorikën e liderëve partiakë, po formësohet karakteri i qeverisjes së ardhshme që do ta imponojë VMRO-DPMNE, me numrin e deputetëve në Kuvend, kryeministrin, shumicën e ministrave në krye të sektorëve më të rëndësishëm në shtet dhe, me shumë mundësi, një mbulim të fortë mediatik.

Kapacitetit të ulët integrues, si dobësi e natyrshme e demokracisë elektorale liberale, do t'i shtohen edhe disa veçori, të cilat u paralajmëruan në fushatën parazgjedhore:

- **Kontrolli mbi mediat dhe lirinë e shprehjes:**

Për të qëndruar në pushtet, VMRO-DPMNE duhet të tregojë se politika e saj e rezistencës kundër "të qenit vasal" ndaj Uashingtonit dhe Brukselit, kundër "shantazhit" të Athinës dhe Sofjes është e justifikuar, që do të thotë se do të duhet të forcojë kontrollin mbi mediat dhe lirinë e shprehjes.

- **Përforcimi i retorikës nacionaliste:**

Për ta mbajtur qeverinë sado-kudo stabile, VMRO-DPMNE-ja do të duhet të intensifikojë retorikën nacionaliste, pasi partneri i tyre i koalicionit VLEN kërkon vazhdimin e negociatave të anëtarësimit me Brukselin dhe hapjen e një procedure kushtetuese për përfshirjen e bullgarëve në Kushtetutë. Në qoftë se qëndron në politikën e deritanishme *të konfrontim*it, kryeministri do të ndajë udhën me interesat e qytetarëve shqiptarë në vend dhe të opozitës parlamentare.

- **Rritja e populizmit:**

Për të qëndruar në pushtet, në kushte të konfrontimit me politikën evropiane dhe amerikane, VMRO-DPMNE-së do t'i duhet të forcojë retorikën e saj populiste dhe të drejtohet kah regjimet e ngjashme në fqinjësi. Që tani, në fjalimet e udhëheqësisë s*ë partisë transmetohet mesazhi: atë e do populli, ne e duam atë, që domethënë ne jemi populli, unë jam populli. Për shembull,* kurora e vendosur së fundmi në Romë pa emrin e shtetit u interpretua nga vëzhguesit si kurorë private e presidentes Gordana Siljanovska-Davkova, për të cilën ajo nuk ka të drejtë.

- **Forcimi i tipareve autoritare të sistemit:**

Demokracitë e reja priren të zhvendosin pushtetin nga institucionet në qendrat e pushtetit joformal. Vendi ynë nuk bën përjashtim. Tani, VMRO-DPMNE do t'i forcojë ato karakteristika autoritare. Në disa deklarata, Hristijan Mickoski tha se nuk do të bëjë lëshime para "shantazheve" bullgare dhe do të shqiptojë emrin "Maqedoni", duke provokuar Athinën. Strategjia e tij është që, nëse nuk vazhdojmë negociatat me BE-në - e kjo nuk ishte asgjë e tmerrshme - do të kthehemi drejt vendit dhe do të punojmë *për përmbushjen e kri*tereve të Kopenhagës, investime, sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit, në mënyrën më të shpejtë dhe më efikase. Kjo është e pamundur pa një "dorë të fortë". Mickoski, që tani, në fushatë ka paralajmëruar shpërbërjen e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë për të trajtuar në mënyrë efikase korrupsionin e pushtetit të kaluar. Nuk është e nevojshme të thuhet asgjë më shumë, sepse gjyqtarët, apo disa gjyqtarë do të dinë se kë duhet të zgjedhin dhe si të gjykojnë.

- **Strategjia neoliberale kufizuese dhe jodemokratike:**

Presidentja, e cila është thelbësisht "maqedoniste", e fshehur pas proceduralizmit, me deklaratat dhe veprimet e saj paralajmëron një strategji të ashtuquajtur neo-liberale të zhvendosjes së çështjeve më të rëndësishme të shoqërisë nga sfera e politikës në sferën juridike. Gjatë gjithë fushatës, ajo pohonte se ka mjaft argumente bindëse juridike në kriteret e Kopenhagës, për të përmbysur apo rishikuar MKO, Marrëveshjen e Prespës, Marrëveshjen me Bullgarinë, si dhe të ashtuquajturin "propozim francez". Në momentin kur mori detyrën si presidente dhe u përball me reagimin e opinionit ndërkombëtar, ajo e zbuti retorikën, sepse kjo etikë legaliste është jo vetëm mjaft kufizuese, por edhe e rrezikshme për vendin.

- **Demokracia si sundim i shumicës**

Në kuadrin e një strategjie neo-liberale, bën pjesë edhe promovimi i demokracisë ekskluzivisht si sundim i shumicës, për *të cilin ka kohë avokon* presidentja Gordana Siljanovska - Davkova, por edhe intelektualë të tjerë që i japin një mbulesë "shkencore" nacionalizmit të shumicës. Për shembull, në fushatën parazgjedhore, ajo për Marrëveshjen Kornizë të Ohrit dhe ndryshimet kushtetuese deklaroi se ato janë një zgjidhje e përkohshme dhe se do të formojë një komision ekspertësh, të cilët do të punojnë për një kushtetutë të re, *në vend të kësaj* "Frankenshtajn" kushtetute.

## Nacionalizmi fitoi!

Shkurtimisht, një fitore kaq e madhe zgjedhore e VMRO-DPMNE-së dhe Gordana Siljanovska - Davkovës në zgjedhjet e fundit presidenciale dhe parlamentare është rezultat, para së gjithash, i shqetësimit dhe frustrimit burimor, por edhe të krijuar qëllimisht të qytetarëve për shkak të lëshimeve që janë bërë ndaj komunitetit shqiptar në vend, ndaj Greqisë dhe Bullgarisë, Uashingtonit dhe Brukselit. Gjatë fushatës dhe para saj, Siljanovska - Davkova dhe Mickoski këto marrëveshje i quajtën gabime historike për të cilat do të kërkohet përgjegjësi, poshtërim, lakim shpine, politikë e disfatës, lëshim, tradhti ndaj interesave kombëtare etj.

Politika e qeverive (kryesisht e LSDM-së dhe BDI-së), të cilat e drejtuan procesin e përshtatjes së vendit me realitetet e politikës së brendshme dhe ndërkombëtare, u pagua me një disfatë të madhe zgjedhore.

Nuk ka asgjë më të lehtë, më fitimprurëse dhe më popullarizuese sesa të jesh nacionalist. Një pozicion i sigurt dhe komod që jo për herë të parë sjell një fitore zgjedhore. Një definicion me humor thotë: "*Nacionalizmi të mëson vetëm të urresh njerëzit që nuk i ke takuar kurrë dhe të jesh krenar për gjërat që nuk kanë të bëjnë me ty*"[8].

Linja mes patriotizmit dhe nacionalizmit është e hollë, e në një shoqëri multietnike aq e hollë sa nuk vërehet kur kapërcehet. Profesori dhe senatori amerikan Patrik Mojnihan ka një shpjegim të bukur: "*Në shprehjen më poetike të patriotizmit, është e pamundur të dallosh se cili është virtyti më i madh njerëzor nga dobësia më e keqe njerëzore – egoizmi kolektiv*"[9].

Në teorinë sociale, është e njohur teza e Daniel Bell, për shembull, se qytetarët që nuk mund të përparojnë vertikalisht në hierarkinë shoqërore, fajin e kërkojnë tek "tjetri" më i dobët, i cili është në të njëjtin nivel të shkallës sociale. Nëse nevojitet mobilizimi dhe homogjenizimi i grupit, 'tjetri' i zakonshëm do të demonizohet në një 'tjetër të papajtueshëm'. Këto janë zakonisht minoritetet, emigrantët, grupet e pakicave fetare dhe të gjithë 'të ndryshmit' nga kultura dominuese.

Ne nuk kemi kërkime të këtij lloji, por me siguri se po e ndjekim këtë trend. Edhe pse narrativa nacionaliste përforcohet gjithmonë në fushatat zgjedhore, kulmi u arrit në zgjedhjet e fundit. Shtizat u thyen rreth dy temave, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në marrëdhëniet ndëretnike:

1. *Politika fqinjësore dhe ndërkombëtare*
2. *Rregullimi kushtetues i vendit dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO)*

## Politika fqinjësore dhe ndërkombëtare

Është e qartë se politika e VMRO-DPMNE-së dhe Gordana Siljanovska - Davkovës në aspektin e politikës ndërkombëtare (futja e pakicës bullgare në Kushtetutë dhe rishikimi dhe/ose anulimi i marrëveshjeve me Greqinë, Bullgarinë dhe "propozimin francez" të BE-së) do të ndajë udhët me interesat e dy koalicioneve shqiptare, të cilat kërkojnë tejkalimin e menjëhershëm ose sa më të shpejtë të problemeve me fqinjët dhe vazhdimin e negociatave me BE-në. Strategjia e Siljanovska - Davkovës dhe Mickoskit që u formësua gjatë fushatës zgjedhore - që të kundërshtojnë Athinën duke përdorur emrin e vendit si ‹Maqedoni› dhe të rinegociojnë me Brukselin rreth kushteve në të ashtuquajturin "propozimi francez" - është joreale, për shkak të reagimeve të ashpra që vijnë nga Athina, Sofja, Brukseli dhe Uashingtoni. Paralajmërimet se negociatat e reja nuk janë një alternativë reale dhe se qasja jonë në BE do të bllokohet, u intensifikuan pas fjalimit inaugurues të presidentes së re, i cili u vlerësua si një provokim ose si një veprim "fatkeq dhe për keqardhje".

Kriza politike, e cila keqpërdoret lehtësisht në marrëdhëniet ndëretnike, duket e pashmangshme për shkak të qëndrimeve të palëkundura, identike të partisë VMRO-DPMNE, Hristijan Mickoskit dhe kryetares Gordana Siljanovska – Davkova, nëse ato nuk zbuten nga presioni ndërkombëtar. Më 9 maj 2024, në emisionin "Samo intervju" (Vetëm intervistë) në TV Kanal 5, Mickoski tha se nuk ka ndërmend të mbështesë të ashtuquajturin "propozim francez" derisa nuk shtohet aneksi që, në momentin që të hyjmë në BE, do të fillojë procedura kushtetuese për përfshirjen e bullgarëve në Kushtetutë. I pyetur se nëse nuk ka një aneks të tillë, ai u përgjigj: «Atëherë do t›i drejtohemi detyrave të shtëpisë dhe do të presim që dikush i arsyeshëm të vijë nga ana tjetër»[10].

Me të njëjtin mendim është edhe presidentja e vendit me argumentin: "Bullgarët janë të mbrojtur edhe tani sepse hyjnë në kategorinë e të tjerëve, ashtu si boshnjakët dhe kroatët në kushtetutën sllovene, aty përmendet vetëm komuniteti italian (post nga Siljanovska - Davkova në rrjetin social X)

Sa i përket përdorimit të emrit të shtetit, gjithashtu nuk ka dallim në qëndrimet e presidentes Gordana Siljanovska - Davkova dhe Hristijan Mickoskit, se kanë të drejtë personale të përdorin 'Maqedoni' në gjuhën e folur. Ja disa deklarata karakteristike të Gordana Siljanovska - Davkovës (të publikuara në rrjetin X), e cila nuk e përdori emrin kushtetues të shtetit në fjalimin inaugurues dhe shkaktoi incident diplomatik:

*"Gjithçka që keni pranuar është e gabuar"*

*"Marrëveshja e Prespës është ende e hapur ligjërisht dhe politikisht".*

*"Ajo "e Veriut..." le të qëndrojë para meje, mirëpo unë them, për mua kjo çështje nuk do të mbyllet kurrë!"*

"Kam të drejtën e dinjitetit. Nëse dikush më thotë të përdor 'e veriut', nuk do ta bëj"

"Unë kurrë nuk do ta përdor republika e Maqedonisë së Veriut! Nuk do ta përdor!"

Duke gjykuar nga këto deklarata, ata nuk kanë "strategji daljeje" dhe janë të robëruar nga nacionalizmi që shkaktuan vetë. Me kalimin e kohës, veçanërisht nëse vendi mbetet pas të tjerëve në rajon dhe «maqedonizmi» forcohet, bashkëqytetarët tanë shqiptarë me të drejtë do të pyesin veten: Pse jemi bashkë?

## Rregullimi kushtetues i vendit dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO)

Tema zgjedhore që më së shumti ndikon në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve në vend është problematizimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe rregullimit kushtetues konsocial. Por për t'u kuptuar gjuha e mohimit, e cila ndonjëherë në fushatë shndërrohej në gjuhë urrejtjeje, duhet t'i kthehemi asaj që përbën konsocionalizmin dhe "ndarjen e pushtetit" (power-sharing).

Në shkencën politike, njihen dy tradita kryesore të demokracisë liberale si një sistem i bazuar në parimin e "sundimit të popullit": liberalizmi 1 dhe liberalizmi 2.

'Liberalizmi 1' (terminologjia e Çarlls Tejllorit) u përkushtohet në mënyrën më të fortë të mundshme të drejtave individuale, që presupozon një shtet jashtëzakonisht neutral pa asnjë qëllim kolektiv, projekte kulturore ose fetare që shkojnë përtej lirisë personale, sigurisë fizike, mirëqenies dhe sigurisë së qytetarët e saj. Një qasje e tillë nuk i miraton të drejtat kolektive të bashkësive etnike, por njeh vetëm parimin e shumicës, një qytetar - një votë.

'Liberalizmi 2' lejon një shtet që i përkushtohet përparimit të një kombi, kulture ose feje të caktuar, ose një numri të kufizuar të kombeve, kulturave dhe feve - përderisa të drejtat themelore të qytetarëve që kanë aspirata të ndryshme ose nuk kanë aspirata të atij lloji janë të mbrojtura. Vetë Tejllor preferon llojin e dytë të liberalizmit. Ai është kanadez dhe teza e tij është se mosnjohja e tjetrit ose njohja e gabuar mund të shkaktojë dëm, të jetë një mënyrë nënshtrimi dhe të mbyllë njeriun në një formë të rreme, të shtrembëruar dhe të reduktuar ekzistence. "*Njerëzit dhe grupet kanë nevojë për respekt dhe njohje dhe shteti duhet t'u ofrojë garanci në atë drejtim*"[11], mendon ai.

Shtrohet pyetja nëse dhe si mund të zbatohet ky koncept i demokracisë liberale në kushtet moderne, ku çdo lloj diversiteti kërkon njohjen dhe rishpërndarjen e burimeve. A nuk e vë në dyshim autonominë e individit politika e njohjes së etnisë? Këto janë sigurisht pyetje legjitime, por qëndrimi i përbashkët i kësaj tradite është se përjashtimi i përhershëm i komuniteteve më të vogla nga qasja në instrumentet e pushtetit mund të çojë në konflikt etnik.

Kësaj tradite i përkasin shumë emra të njohur nga teoria politike, Arend Liphart, Donal Horouic, RobertGur, Adrian Gelke, Uill Kimlika, Millan Podunavac e të tjerë.

Më i famshmi prej tyre është Arend Liphart, një profesor amerikan me origjinë holandeze, i cili konsiderohet babai i demokracisë konsocionale dhe sistemit të ndarjes së pushtetit (power-sharing). Ai shkroi disa vepra në mbrojtje të këtij modeli, por vendi që prek thelbin e problemit të pakicave të neglizhuara apo të diskriminuara, që na prek ne si shoqëri multietnike, është ky: "Në shoqëritë pluraliste, sundimi i shumicës krijon diktaturë të shumicës dhe ndarje të qytetarëve, më shumë se sa demokraci. Ajo që u nevojitet këtyre shoqërive është një sistem demokratik që i jep përparësi konsensusit në vend të opozitës, që më shumë përfshin sesa përjashton, që kërkon të zgjerojë shtrirjen e shumicës qeverisëse në vend që të kënaqet me një shumicë të thjeshtë: demokraci konsensuale" (Lijphart 1984: 23)[12].

Ka dallime në zgjidhjet specifike institucionale të ofruara nga këta autorë. Disa janë më integrues, të tjerë më federalistë, por thelbi është i njëjtë: konsocionalizmi është po aq formë demokratike e qeverisjes sa edhe sistemi i shumicës, gjë që duhet nënvizuar, sepse në teorinë dhe praktikën tonë politike ky model konsiderohet më pak demokratik se sa demokracia e shumicës, bazuar në parimin një qytetar - një votë.

Nëse pyesim veten se pse kjo nuk u vu re pas fitimit të pavarësisë së Maqedonisë në vitin 1991, do të kujtoj fjalët e profesorit kanadez Uill Kimlika, se shtetet nacionale zakonisht nuk janë të prira për të shtrirë drejtësinë ndaj grupeve minoritare që i konsiderojnë të pabesë ose kërcënim për sigurinë. Përfundimi i tij, bazuar në studimet e shembujve individualë, tregon se politika e njohjes dhe e drejtësisë gjuhësore nuk mund të zërë rrënjë autentike në një shoqëri, derisa nuk zgjidhet frika bazë rreth lojalitetit dhe sigurisë. Kjo ishte situata në Maqedoni, kur ajo u ndërtua pas vitit 1991 si shtet nacional i popullit maqedonas me të drejta të garantuara për pakicat.

Debati për modelet e demokracisë liberale jo vetëm që u shpërfill në rrethet tona intelektuale, por u konsiderua si jopopullor dhe madje gjë e rrezikshme të vihej në pyetje demokracia e shumicës, e kurorëzuar me kushtetutën e parë të vendit. Pothuajse askush nga shkenca nuk kundërshtoi se nën 'sundimin e popullit' nënkuptohet shumica e maqedonasve etnikë.

Përfaqësuesit politikë të shumicës, si dhe qarqet akademike në Maqedoni, favorizuan liberalizmin 1 ose mazhoritarizmin, bazuar në parimin e barazisë politike të individit, si parim themelor demokratik. Argumentet e tyre në debat ishin se çdo individ ka të njëjtën peshë dhe se çdo votë është po aq e zëshme. Kjo shpesh përmblidhet si një qytetar - një votë.

Debati në rrethet akademike për këtë temë ka nisur pas përleshjes së Gostivarit mes qytetarëve dhe policisë, më 9 korrik 1997. Një vit më pas, profesori universitar Gjorge Ivanov mbrojti tezën e doktoratës, në të cilën hodhi poshtë mundësinë e suksesit të modelit konsocional në Maqedoni. Debati u intensifikua pas vitit 2001. Kritikët më të mëdhenj të MKO-së dhe modelit konsocional ishin profesoreshat Biljana Vankovska dhe Gordana Siljanovska - Davkova. Vankovska, për shembull, pohente se modeli i ndarjes së pushtetit, i pranuar me forcë, nuk do të çojë në integrim dhe demokraci, por në shpërbërje dhe regres. Argumenti themelor i Siljanovska - Davkovës atëherë, si edhe sot në fushatën zgjedhore, konsiston në pohimin se parimi themelor kushtetues është vendosja e një sistemi në të cilin qytetari është bartës i sovranitetit (demos), e jo të zëvendësohet me kolektivitet (etnos).

Në vend kishte një sistem mazhoritar nga viti 1991 deri në 2001 dhe ai dështoi.

Nënkuptohet se argumentet pro dhe kundër modelit konsocional mund të përballen në nivel akademik. Disa nga kritikat e bëra janë të sakta, e mund të shtohen edhe të tjera. Por ajo që qëllimisht u nënvlerësua në fushatën zgjedhore është se ky model mundësoi qeverisje paqësore në njëzet vitet e fundit, akomodim të bashkësive etnike dhe zgjidhje të tensioneve etnike përmes procedurave demokratike. Ka lindur një ndjenjë më e madhe barazie dhe drejtësie, edhe pse sigurisht që praktika nuk është gjithmonë në përputhje me modelin. Të vësh në dyshim këtë zgjidhje kushtetuese, siç bëri Hristijan Mickoski dhe veçanërisht Gordana Siljanovska - Davkova në fushatën parazgjedhore, është shkelje e drejtpërdrejtë e marrëdhënieve ndëretnike në vend dhe destabilizim.

Konsocionalizmi u kritikua vazhdimisht gjatë fushatës dhe u premtua një kushtetutë e re qytetare. Presidentja njoftoi se do të formojë një grup ekspertësh për hartimin e një kushtetute të re, moderne, qytetare; se kjo është një arnim i thjeshtë lara-lara dhe ' Frankenshtajn kushtetutë ', duke iu referuar amendamenteve të shumta të miratuara pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. *"Problemi është se kemi dy qeveri në një, dy parlamente që nuk komunikojnë me njëri-tjetrin. Ne kemi nevojë për ndryshime themelore kushtetuese për këtë "Frankenshtajn" kushtetutë*", tha ajo në debatin televiziv të kandidatëve për president në TVM më 21 prill 2024.

Për të minuar legjitimitetin e modelit kushtetues të 'ndarjes së pushtetit', fushata u zhvillua rreth temave të vendosura në retorikën nacionaliste· Më e suksesshme u tregua ajo që pretendonte se shqiptarët na e morën shtetin, se ata janë 'pronarët në shtëpi', se maqedonasit janë 'qiraxhinjtë' dhe se në koalicionin LSDM është "shërbëtor" i BDI-së. Slogani zgjedhor "Maqedonia përsëri e jotja" i referohet këtij konteksti, duke përfshirë "të qenit vasal" ndaj Uashingtonit dhe Brukselit. Edhe pse kalimi i supozuar i pushtetit nga mazhoranca në duart e pakicës quhej "BDI-zëm", në fakt ishte një platformë ant-ishqiptare, e cila u përhap në shoqëri deri në atë masë, sa çdo strategji tjetër shpallej tradhti.

Në Forumin "Si ta mbrojmë identiteti maqedonas", kreu i Kishës Ortodokse Maqedonase, z. Stefan, në këtë kontekst do të thotë: "Është e trishtueshme kur ujku sulmon delet, por është edhe më e tmerrshme kur ato sulmohen nga qeni i Sharrit, kur ujqëzohet ai, roli i të cilit është të mbrojë kopenë nga ujqërit"[13].

Albanofobia nuk është një fenomen i ri. Partia VMRO-DPMNE zhvilloi fushatën e saj të parë zgjedhore në vitin 1990 si albanofobe, anti-komuniste dhe anti-serbe.

Hristijan Mickoski, për shembull, në emisionin "Samo intervju" (Vetëm intervistë) në Kanal 5 deklaroi: "Tash na ndodh që popullsia pakicë të vendosë për shumicën, edhe atë për çështje kyçe të identitetit".

Në të njëjtën intervistë, Mickoski flet për perceptimin e qytetarëve. Atyre iu është marrë shteti dhe për këtë VMRO-DPMNE fitoi 437.000 vota dhe 58 mandate. Ai pyet veten, sa kohë do të jetojmë në një shoqëri ku pakica do të sundojë shumicën?

Ish-deputeti i VMRO-DPMNE-së, Ilija Dimovski, ka bërë një deklaratë të ngjashme: "I gjithë pushteti iu la BDI-së,...Është pafuqi...Më e rëndësishmja është që BDI-ja i lejoi vetes të udhëheqë procese që kanë të bëjnë me kombin maqedonas... Askush nuk mund të hyjë në shtëpinë time dhe të më thotë se mund ta bësh këtë, nuk mund ta bësh atë..."[14].

Sfidimi i legjitimitetit të rregullimit kushtetues konsocional mund të shihet edhe pas sulmit të ashpër në fushatën parazgjedhore ndaj të ashtuquajturit balancues, mjet për zbatimin e dispozitës kushtetuese për përfaqësim të drejtë·

Balancuesi nuk është dhe nuk mund të jetë një mjet ideal. Sigurisht që abuzohet në praktikë. Por nuk është e vërtetë, siç pretendohet në fushatë, se nuk kujdeset për cilësinë e kandidatëve. Edhe pse pozitat në administratën publike që i përkasin komuniteteve më të vogla janë përcaktuar paraprakisht, të gjitha konkurset e shpallura kërkojnë kritere sipas sistemit të meritave. Nevojiten kërkime të mëtejshme se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe në këtë sistem, por sulmet e përgjithshme ndaj balancuesit synojnë të diskreditojnë parimin kushtetues të përfaqësimit të drejtë. Presidentja Siljanovska - Davkova në një rast gjatë fushatës parazgjedhore deklaroi: "Duhet të ndalojmë aplikimin e gabuar të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat. Edhe në Marrëveshjen Kornizë, së pari shkruhet ekspertiza dhe kompetenca, e më pas çdo përfaqësim".

## Epilogu

Epilogu, për mendimin tim, është mjaft dekurajues, por në të njëjtën kohë kthjellues. Ai flet për një komb thellësisht të frustruar, i cili ka arsye objektive për hidhërimet, por edhe që ato ushqehen qëllimisht nga sipërmarrës të ndryshëm politikë për të marrë dhe qëndruar në pushtet. Çmimi i kthjellimit do të jetë i lartë dhe do ta paguajmë të gjithë ne qytetarët. Sepse tani qeveria, këtu mbi të gjitha kam parasysh VMRO-DPMNE-në, duhet të përballet me faktin se politika nuk është një fletë e bardhë dhe se në marrëdhëniet ndërkombëtare shpeshherë pushteti/forca dominon mbi barazinë formale të shteteve.

Në periudhën e ardhshme, qytetarët duhet të binden se koncesionet e bëra nga vendi nga viti 1991 e deri më sot, të cilat nacionalistët i shpallën si tradhti dhe gabime historike, janë në fakt suksese që stabilizuan shtetin dhe i mundësuan të rrisë sigurinë e tij.

Gjatë fushatës zgjedhore mbizotëroi narrativi dhe retorika nacionaliste, veçanërisht nga ana e VMRO-DPMNE-së.

Nga ana e Hristijan Mickoskit dhe kandidates presidenciale Gordana Siljanovska - Davkova, ajo retorikë nacionaliste kishte për qëllim kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe cenimin e legjitimitetit të MKO-së dhe Kushtetutës. VLEN, nga ana e saj, doli me një program, i cili është gjithashtu konteston modelin kushtetues të konsocionalizmit dhe synon zgjerimin e të drejtave kolektive të komunitetit shqiptar, përtej zgjidhjeve kushtetuese.

Sigurisht, Kushtetuta nuk është një temë tabu. Ka ndryshuar dhe mund të ndryshohet në përputhje me nevojat reale të qytetarëve. Kjo analizë vetëm bën me dije se nacionalizmi i largon qytetarët e kombësive të ndryshme nga njëri-tjetri. Gjithashtu tregon se çdo ndryshim i Kushtetutës kërkon një procedurë adekuate, përndryshe çdo gjë tjetër është ngritje e tensioneve ndëretnike në shoqëri.

Konfrontimi i VMRO-DPMNE-së dhe Gordana Siljanovska Davkovës me fqinjët, Brukselin dhe Uashingtonin për marrëveshjen e Prespës dhe marrëveshjen e miqësisë dhe fqinjësisë së mirë me Bullgarinë, i ndërlikon marrëdhëniet ndëretnike, sepse VMRO-DPMNE kërkon kohë për negociata të reja, kurse koalicioni VLEN dhe partitë e tjera parlamentare në opozitë, kërkojnë vazhdimin sa më të shpejtë të negociatave me BE-në.

Duket se fitorja e madhe elektorale e nacionalistëve mund të rezultojë e hidhur.

*(autorja është profesoreshë universitare e shkencave politike)*

## Literatura e zgjedhur

Guelke Adrian(2012). Deeply Divided Societies. Polity

Bell Daniel(1962). The End of Ideology, Free Press, New York

Lijphart Arend.(1984). Democracies-Patterns of Majoritarian and Consensus Government in Twenty-One Countries. Yale University Press

Lijphart Arend(1977). Democracy in Plural Societies: A comparative Exploration. New Haven and London, Yale University Press

Horowitz Donald. Ethnic Groups in Conflict. University of California Press

Kymlicka, W. (2002). Multiculturalism and Minority Rights: West and East. Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe, 4, 1-26.

Moynihan Daniel Patrick(1993). Pandemonium: Ethnicity in International Politics. Oxford: Oxford University Press

Fukuyama Francis (1992) The End of History and the Last Man, Free Press

Podunavac Milan (2002) Fear and Politics, New Balkan Politics 2/2002

Sisk Timoty D.(1996) Power-sharing and international mediation in ethic conflicts. USIP, Washington, D.C. 1996

Тејлор Чарлс(2004). Мултикултураизам. Евро Балкан, 2004

Siljanovska Gordana (2006) Globalisation, Democracy and Constitutional Engineering as Mechanism for Resolving Ethnic Conflict. www.enelsyn.gr/papers/w6/

Vankovska Biljana (2011) Nova Makedonija, 15.8.2011.

## Referencat dhe burimet

1 Bilall Kasami në „360 gradë“, 27 maj 2024, https://www.youtube.com/watch?v=puaAgL8txM4

2 Izet Mexhiti në „Tema e ditës“, TV Sitel, 30 april 2024, e qasshme në https://www.youtube.com/watch?v=I9XK-TY3-UY

3 Po krijohet partia e re shqiptare - Çfarë premton “Vetëvendosje” në Maqedoni?, Faktor, 15 mars 2023, e qasshme në: https://faktor.mk/se-formira-nova-albanska-partija---shto-vetuva-samoopredeluvanje-vo-makedonija

4 Plani 2030, Vlen, e qasshme në https://vlen.eu/wp-content/uploads/2024/04/Programi-VLEN.pdf

5 Intervista e Hristijan Mickoski në “Samo Vistina” në Kanal 5, 9 maj 2024, e qasshme në https://www.youtube.com/watch?v=FQxdQFFGR3I

6 Antonio Milloshoski në Top Tema në TV Telma, 27 maj 2024, e qasshme në https://www.youtube.com/watch?v=_bNHCKg5_84

7 Aleksandar Spasenovski në “Zaspij ako mozhes”, TV Alfa, 28 maj 2024, e qasshme në https://www.youtube.com/watch?v=UWZ9V18HW14

8 Përkufizimi është huazuar nga teksti i Jane Altiparmakov, në Frontline. Ai citon komedianin amerikan Douglas Doug Stanhope

9 Moynihan Daniel Patrick(1993). Pandemonium: Ethnicity in International Politics. Oxford: Oxford University Press

10 Hristijan Mickoski në “Samo intervju”

në TV Kanal 5, 09.05.2024, e qasshme në: https://www.youtube.com/watch?v=kgIkxwxmOyM&t=1661s
11 Çarlls Tejllor(2004). Multikulturalizmi. Euro Ballkan, 2004
12 Lijphart Arend.(1984). Democracies-Patterns of Majoritarian and Consensus Government in Twenty-One Countries. Yale University Press
13 Forumi: "Si ta mbrojmë identiteti maqedonas" - moment vendimtar për ruajtjen e unitetit, burimi TV Alfa, 14.03.2024, e qasshme në https://www.youtube.com/watch?v=_wVb2fEj1mA
14 Ilija Dimovski, intervistë në "Zaspij ako mozhes" në TV Alfa, 23.05.2024, e qasshme në: https://www.youtube.com/watch?v=ielsk298SNg

# 3. MARRËDHËNIET NDËRETNIKE NË KOMUNIKIMIN PUBLIK GJATË ZGJEDHJEVE: VAZHDON DOMINIMI I DISKURSIT ETNOCENTRIK

Shkruan: SEFER TAHIRI

Historia 34 vjeçare e pluralizmit politik në Maqedoninë e Veriut dëshmon se marrëdhëniet ndëretnike, sidomos ato midis maqedonasve dhe shqiptarëve, janë (keq)përdorur nga partitë politike në zgjedhjet parlamentare, presidenciale, madje edhe ato lokale.

Në këtë kontekst, diskursi mediatik - politik shpeshherë ka qenë "diskurs i dallimit". "Paradigma e dallimit", përkatësisht diskursi etnocentrik, e ka ndjekur debatin politik, por edhe përmbajtjet mediatike, pavarësisht vallë është zhvilluar në gjuhën maqedonase ose shqipe.

Duke marrë parasysh këto aspekte, kjo analizë fokusohet në disa çështje dhe shembuj të komunikimit politik dhe raportimit mediatik gjatë zgjedhjeve: Sa ishin marrëdhëniet ndëretnike në fokus të fushatës parazgjedhore të partive politike për zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 2024? Cila ishte qasja e mediave shqiptare dhe maqedonase lidhur me deklaratat konfrontuese midis liderëve të BDI dhe VMRO-DPMNE, Ali Ahmetit dhe Hristijan Mickoskit? Si u keqinterpretua deklarata e kandidates presidenciale, Gordana Siljanovska mbi rastet e luftës së vitit 2001? Sa patën hapësirë tonet nacionaliste të partive E Majta dhe ZNAM? Cila është historia e diskursit etnocentrik në fushën politike dhe mediatike në Maqedoninë e Veriut? A dominohet skena politike dhe mediatike edhe sot, si në vitet 90-ta nga "diskursi i dallimit"?

## Marrëdhëniet ndëretnike në diskursin e partive politike

Duke qenë shtylla e stabilitetit politik dhe e sigurisë, marrëdhëniet ndëretnike janë "çelës", sidomos i partive të djathta, për të fituar sa më shumë vota gjatë zgjedhjeve. Në këtë drejtim, një pjesë e medias ka qenë shpesh dorë e zgjatur, përkatësisht afirmative, por edhe nxitëse, e narrativëve etnocentrike që prodhoheshin në laboratorët partiake.

Pjesa më e madhe e mediave, qoftë publike (në Maqedoninë e Veriut koncepti i medias publike është inekzistent, pasi ende trajtohen si shtetërore), qoftë private apo komerciale, kanë shërbyer më shumë si "zëdhënëse" të politikës, se sa të jenë në funksion të interesit publik. Kjo nënkupton se, duke qenë të tilla, mediat u kanë shërbyer agjendave populiste elektorale, të cilat janë bazuar tek filozofia e madhërimit të një identiteti të caktuar etnik kundrejt identitetit të tjetrit, i trajtuar si i huaj dhe kërcënues, ndërsa në disa periudha edhe si armiqësor apo si "armik i brendshëm", ndonëse për këtë nuk janë ofruar argumente, por më tepër konstruksione imagjinare me narrativ propagandues antishqiptar apo antimaqedonas.

Edhe pse me tone më të buta, politikat etnocentrike vazhduan të jenë pjesë dominuese e fushatës së partive politike në zgjedhjet e vitit 2024, ndërsa një pjesë e

mediave në mënyrë jokritike, e disa edhe afirmative, i pasqyronin tubimet me ikonografi etnocentrike, të kombinuara me folklor etno-populist, duke iu shtuar edhe sloganet e mëdha partiake, që thirreshin tek interesat e popullit, kombit, identitetit, qenies, mbrojtjen e emrit të shtetit, gjuhës, promovimin e integrimit evropian e kështu me radhë. Sloganet dhe porositë kryesore partiake ishin: "Maqedonia përsëri e jotja" (VMRO-DPMNE), "Nuk heqim dorë nga ardhmëria" (LSDM), "Ndryshimi vlen" (Koalicioni VLEN), "Jo Rusisë, po Evropës" (Fronti Evropian), "Ta kthejmë dinjitetin e kombit" (E Majta), "Maksimum për Maqedoninë" (partia ZNAM), "Guximshëm për Maqedoninë" (partia GROM). Siç shihet, në pjesën më të madhe të tyre dominon një vijë identitare kolektiviste. Shfaqja e shpeshtë e tyre në raportimet mediatike, por sidomos në programet e paguara politike me para të qytetarëve i përforcoi të njëjtat, duke i bërë pjesë e përditshmërisë së qytetarëve.

Dy partitë politike që në tri dekadat e fundit më së shumti janë ngritur mbi doktrinat e etnocentrizmit (zgjedhor) janë VMRO-DPMNE-ja dhe BDI-ja, të cilat në zgjedhjet e fundit "mprehën" shpatën e artikulimit të ideve dhe koncepteve politike, duke u thirrur tek idealet respektive etnike - ato maqedonase dhe shqiptare.

## Fushatë parazgjedhore politike- me "gurabi" etnike!

Në fushatën e fundit zgjedhore, përplasjet etno-politike midis VMRO-DPMNE-së dhe BDI-së kanë qenë të përmasave të mëdha, duke dominuar diskursin politik, i shfaqur në tubime me qytetarët dhe në debatet mediatike parazgjedhore.

Si rezultat i këtij konfrontimi, lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, duke iu përgjigjur qëndrimeve të liderit të opozitës maqedonase, sot mandator për formimin e qeverisë së re, Hristijan Mickoski, tha se "ai është rritur duke ngrënë gurabi". Konteksti i kësaj deklarate është t'i bëhet me dije Mickoskit se mosmarrja e Frontit Evropian në qeveri është shkelje e vullnetit politik të shqiptarëve apo majorizim nga pala maqedonase, gjë që shpie drejt krizës së re etnike.

"Mickoski është rritur me gurabija dhe keksa – Ahmeti paralajmëron Mickoskin: Fjalë pas fjale nisë belaja!"[1], ishte titulli i TV 21 nga tubimi, i mbajtur më 22 prill 2024, në të cilin Ahmeti edhe brohoriti "UÇK, UÇK".

**Raport i TV 21: Gurë mbi gurë bëhet kalaja, fjalë pas fjale nisë belaja. Kështu u shpreh kreu i Bashkimit Demokratik për Integrim Ali Ahmeti në tubimin qendror të Frontit Europian. Duke komentuar thirrjet e VMRO-DPMNE-së për të fituar 61 deputetë në zgjedhje, Ahmeti thotë se Mickoski është ende i ri dhe akoma i nxjerrë buza qumësht. "Hristijan Mickoski është rritur me gurabija. Hristijan Mickoski është rritur me keksa. Unë jam rritur në kullë prej guri, Hristijan që tre herë është djegur është prej pushtuesve. Hristijan, populli im thotë gurë mbi gurë bëhet kalaja, fjalë pas fjale nisë belaja, mos nis bela! Mos nis bela dhe mati fjalët se je i ri dhe akoma të qet buza tamël", tha Ahmeti.**

Portali Almakos publikoi deklaratat e liderit integrist me titullin: "Ali Ahmeti i drejtohet Mickoskit: Je rritur me gurabija, mati fjalët dhe mos nis bela!"[2].

Klan Maqedonia raportin televiziv e publikoi me titullin: "Ahmeti-Mickoskit: Mati mirë fjalët kur flet se je ende i ri, ardhmëria e këtij vendi është vetëm në BE!"[3].

Portali Tetovasot raportoi me titullin afirmativ në favor të BDI-së "Fjalimi i Ali Ahmetit kundër Mickovskit pushton rrjetet sociale dhe elektrizon votuesit e rinj"[4]. Ky portal, me gjuhë të thekur propaganduese, shkruante: "**Fjalimi i liderit të BDI-së në Shkup drejtuar një mase të madhe njerëzish, duket se ka elektrizuar masën, informon Tetovasot. Pjesa ku ai i drejtohet liderit të VMRO-DPMNE-së, Mickoskit dëgjohet nga shumë të rinj nëpër vetura që kanë shkëputur atë fragment por edhe ka pushtuar rrjetet sociale"**.

Portali Nistori ka pasur një qasje ndryshe raportuese lidhur me deklarimet e Ahmetit: "Ahmeti në Shkup: UÇK-ja është ajo që e bëri Maqedoninë.[5]"

**Raporti i portalit Nistori: "Ky front dikujt mund t'i vijë pak mërzi se këta të rinj thërrasin UÇK, por UÇK-ja është ajo që e bëri Maqedoninë, dhe i bëri me identitet edhe komunitetet më të vogla. Falënderues ishte edhe i ndjeri Trajkovski se tha UÇK-ja na njohu identitetin fetar, ka qenë çlirimtare, që shqiptarët sot të jenë zot në shtëpitë e veta. Ne kurrë të huajën se kemi dashur por për të jonin kemi luftuar e kemi derdh gjak. Prandaj le t'i masin fjalët mirë se ky shtet e ka vendin në Evropë dhe atje mundemi të shkojmë vetëm bashkë. E kaluara është e dhimbshme, dhe nuk duhet harruar por duhet të luftojmë të gjithë që kjo e kaluar të mos përsëritet".**

Një pjesë e mediave në gjuhën maqedonase e kanë transmetuar në mënyrë objektive dhe korrekte qëndrimin e Ahmetit. Siç vërteton portali për grumbullimin e lajmeve në gjuhën maqedonase Time·mk, titulli më i shpeshtë ka qenë «Ali Ahmeti deri te Hristijan Mickoski: Je rritur me gurabi, mos kërko bela, mati fjalët, ende je i ri"[6]. Sipas linkut të theksuar, portalet që janë të afërta me VMRO-DPMNE-në, si portali Kurir[7], Netpress[8], Republika[9] dhe Presingtv[10] kanë raportuar me titull identik "Ahmeti iu kërcënua Mickoskit: Mos kërko bela". Ky fakt vetvetiu flet për që politika editoriale e këtyre portaleve koordinohet nga një qendër e caktuar.

Portali në gjuhën maqedonase Lider.mk publikoi dezinformatë nga tubimi qendror i BDI-së në Shkup, edhe atë që në titull "Ali Ahmetit me kërcënim të hapur deri te Hristijan Mickoski - do ta qep gojën"[11]. "**Përderisa pas tij valonte flamuri me shqiponjën dykrenare, Ahmeti për liderin e VMRO-DPMNE-së tha: Hristijan Mickoski është rritur me gurabi dhe keksa. Hristijan mos kërko bela dhe mati fjalët, sepse je i ri dhe do ta qep gojën**", raportonte Lider.mk. Në fakt, pjesa e fundit është e sajuar apo është përkthim i gabuar i fjalimit, pasi Ahmeti në vend se do ta "qep gojën" thotë "të qet buza tamël".

## Raportim korrekt në media i përgjigjes së Mickoskit ndaj Ahmetit

Përgjigja e menjëhershme e Mickoskit ndaj deklaratave të Ahmetit ka zënë hapësirë të madhe në mediat në gjuhën shqipe dhe maqedonase.

Portali Lajmpress raportoi me titullin "Mickoski i përgjigjet Ahmetit: Gurabijet dhe qumështi do të ju ngecin në fyt![12]". Ky portal e publikoi në mënyrë të plotë përgjigjen e Mickoskit në rrjetin social Fejsbuk. Ndërsa portali Pacensurë publikoi përgjigjen me titullin: "Mickoski i përgjigjet Ali Ahmetit: Kërcënimet vijnë nga një burrë para daljes në pension politik dhe pak i harruar"[13].

"Mickoski i'a kthen porosinë Ahmetit" ka qenë titulli neutral dhe korrekt i disa portaleve, të cilët e transmetuan deklaratën e Mickoskit, edhe atë: Tetovasot[14], Inaonline[15], Faktiditor[16], Opentv[17].

Një pjesë e portaleve në gjuhën shqipe, si Gazetaexpress[18], Lajmpress[19], Tetovasot[20], Syri.mk[21] i kanë dhënë hapësirë të konsiderueshme deklaratës së liderit të partisë Dinjiteti, Stojanço Angellov, i cili i dërgoi porosi Ahmetit se "Pas Mickoskit qëndrojnë "branitellat" (pjesëtarët e forcave shtetërore të sigurisë që luftuan në vitin 2001).

Ndërsa disa portale, siç vërteton grumbulluesi Fax.al, kanë raportuar me titullin "Ahmeti brohoriti UÇK në qendër të Shkupit", Angellov: Përdorni frenat e dorës, pas Mickoskit janë "branitellat" që ju fituan në vitin 2001".[22]

Mediat në gjuhën maqedonase, thuajse në mënyrë konsensuale, pa dallim se a janë me proveniencë politike proqeveritare apo proopozitare, përgjigjen e Mickoskit ndaj Ahmetit e raportuan me titullin "Mickoski ia ktheu Ahmetit: Shumë shpejt gurabitë dhe qumështi do të mbeten në fyt"[23]. Përgjigjen e Mickoskit në Fejbuk, këto media e raportuan në mënyrë objektive dhe të plotë, duke iu përmbajtur transmetimit integral apo transimisionues.

## Pasqyrimi mediatik i qëndrimit të Siljanovskës mbi veprat e luftës së vitit 2001

Deklarata e kandidates presidenciale të VMRO-DPMNE-së, sot presidente aktuale, Gordana Siljanovska - Davkova e dhënë në Kumanovë më 29 prill 2024, në të cilën theksoi se "të ashtuquajturat vepra kundër njerëzimit asnjëherë nuk vjetërsohen", bëri bujë në mediat në gjuhën shqipe.

Ka qenë Televizioni Alsat, i cili i pari publikoi informacionin mbi qëndrimin e Siljanovskës. Titulli i këtij televizioni ishte: "Fushata presidenciale/ Nga tribunal ndërkombëtar për luftën e 2001-së, deri tek mos besimi te ata që kërkojnë anulimin e marrëveshjeve që sollën paqe[24]". Siç vërtetohet edhe nga linku i publikuar, kjo përmbajtje është fshirë nga uebfaqja në gjuhën shqipe e televizionit me licencë nacionale teresteriale. Është fshirë edhe nga uebfaqja e TV Alsat në gjuhën maqedonase[25].

Redaksia e TV Alsat nuk e ka arsyetuar para publikut me vendim editorial apo argumente se pse ka ndodhur publikimi dhe më pas zhdukja e këtij informacioni. Aq më tepër që, duke iu referuar këtij televizioni, përmbajtjen e njëjtë e kanë transmetuar edhe shumë media tjera tradicionale, por edhe të reja, disa prej të cilave me të njëjtin titull:

- Nga tribunal ndërkombëtar për luftën e 2001-së, deri tek mos besimi te ata që kërkojnë anulimin e marrëveshjeve që sollën paqe[26] (Tetova sot, 29 prill, 2024)
- Fushata presidenciale/ Nga tribunal ndërkombëtar për luftën e 2001-së, deri tek mos besimi te ata që kërkojnë anulimin e marrëveshjeve që sollën paqe[27] (TV News, 29 prill, 2024)
- Fushata presidenciale: Nga tribunal ndërkombëtar për luftën e 2001-së, deri tek mos besimi te ata që kërkojnë anulimin e marrëveshjeve që sollën paqe[28](Infoshqip, 29 prill, 2024)

Një pjesë e madhe e mediave, deklaratën e Siljanovskës, siç dëshmon portali i grumbullimit të lajmeve Fax.al, e kanë transmetuar me titullin: "Siljanovska propozoi tribunal ndërkombëtar për luftën e vitit 2001?"[29].

Edhe TV 21, e transmetoi deklaratën e saj, duke e bërë të mirëqenë faktin se Siljanovska kërkon tribunal ndërkombëtar për konfliktin e vitit 2001. Përkatësisht, titulli

ishte spekulativ, si ai i përmendur më lartë "Siljanovska propozoi tribunal ndërkombëtar për luftën e vitit 2001?"[30], pasi në brendinë e tij, raporti televiziv nga terreni nuk ofron fakte se presidentja ka kërkuar në mënyrë decide themelimin e një tribunali ndërkombëtar për vitin 2001.

**Raporti i TV 21: "Kandidatja për presidente nga koalicioni i VMRO-DPMNE-së, Gordana Siljanovska-Davkova në tubimin e mbrëmjes së djeshme në Kumanovë foli për të drejtën ndërkombëtare, respektivisht tha se "disa vepra kundër njerëzimit nuk vjetërsohen kurrë". Siljanovska në fjalimin e saj përmendi edhe luftën e vitit 2001. "Vetëm të rikujtoj, edhe në vitin 2001 PDSH ishte në Qeveri, do të thotë unë nuk i kërcënohem akujt, vetëm përkujtoj që disa vepra, të ashtuquajturat vepra kundër njerëzimit asnjëherë nuk vjetërsohen", tha Siljanovska".**

Qëndrimit të Siljanovskës mediat në gjuhën maqedonase nuk i kanë dhënë hapësirë informative.

## Siljanovska: Qeveri pa shqiptarë nuk është zgjidhje e mirë

Në kontekst të trajtimit të marrëdhënieve ndëretnike në media, është për t'u veçuar edhe një qëndrim i shprehur nga presidentja Siljanovska. Në intervistë për emisionin Triling[31], ajo u shpreh se "**Pa dallim nga rezultati, qeveri pa partitë shqiptare nuk është zgjidhje e mirë. Kabineti i presidentit pa shqiptarë nuk është zgjidhje e mirë. Në kabinet duhet të jenë shqiptarët kompetent dhe profesional**". Por, kjo deklaratë, nuk është se u trajtua në mënyrë interpretuese në mediat shqiptare dhe maqedonase.

## Apasievi merr hapësirë të vogël në mediat maqedonase, thuajse injorohet nga shqipet

Qëndrimi i liderit të partisë E Majta (Levica), Dimitar Apasiev kundër BDI-së dhe Lidhjes Socialdemokrate, u transmetua vetëm në pak media maqedonase, me titullin "Apasievi nga Tetova: Në pushtetin e uçkistëve nga BDI-ja, të mbështetur nga elita e korruptuar maqedonase, çdo i dyti fëmijë nga Pollogi lind në Zvicër"[32]. Kërkimet tregojnë se nga mediat shqipe, i vetmi Televizioni Klan Maqedoni ka transmetuar deklaratën e Apasievit me titullin "Zgjedhjet parlamentare/ Apasiev: Me UÇK-në e BDI-së dhe elitave maqedonase, çdo I dyti fëmijë në Pollog lind në Zvicër". Për shkak të qëndrimeve të shprehura radikale mbi shumë çështje politike, lideri i partisë E Majta me sa duket u bojkotua nga një pjesë e madhe e mediave.

## Partia ZNAM i rikthehet flamurit të Verginës

Portali Racin publikoi titull kritik ndaj valimit të flamurit të "Verginës" në tubimet politike të partisë ZNAM. Ky portal raportoi me titullin "Dimitrievski nga ZNAM duke dëshiruar pushtet i valoi "verginat"[33]. Portali raportoi se "**Maksim Dimitrievski, lideri i partisë ZNAM, fjalimet e tij para qytetarëve në Ohër dhe Strugë i mbajti nën flamurin e Verginës, simbol, i cili është ikonografi e zakonshme e VMRO-DPMNE-së dhe partive tjera me përcaktim të djathtë konzervativ. Kjo mund të shihet nga fotografitë në**

**Fejsbuk si dhe në videon e publikuar në këtë rrjet"**. Evidente është se mediat tjera nuk i kanë kushtuar rëndësi këtij detaji të shfaqur në tubimet e ZNAM-it.

## Histori e shkurtër e marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoninë e veriut

Nga vitet 90-ta, në sferën mediatike - publike është prodhuar imazhi negativ për "tjetrin", duke e portretizuar si kërcënim apo rrezik i mundshëm, pra si një "gogol", i cili gjithmonë është i gatshëm t'i shkaktojë ndonjë të keqe palëve etnike, të cilat pavarësisht se jetojnë me shekuj në këto troje, nuk kanë besim të lartë të ndërsjellë.

Pikërisht diskursi mediatik, i shfaqur në mediat tradicionale dhe mediat e reja e ka thelluar edhe më shumë jazin ndëretnik, duke përforcuar etnocentrizmin dhe rrymat politike me retorikë radikale në dy kampet etnike, duke filluar nga vitet 90-ta deri në konfliktin e armatosur në vitin 2001. Një diskurs i tillë ndarës ka qenë sidomos i pranishëm gjatë raportimit dhe interpretimit mediatik politik gjatë krizës apo luftës në mediat komerciale. Edhe shërbimi radiodifuziv publik- RTVM (tani Radiotelevizioni Kombëtar) ka shfaqur dy realitete etnike, njëri shqiptar dhe tjetri maqedonas.

Diskursi në komunikimin publik, në vend të kohezionit ndëretnik dhe integrimit shoqëror, krijonte mosdurim mes maqedonasve dhe shqiptarëve. Ky mosdurim shfaqej kryesisht në realitetin e konstruktuar mediatik, por edhe në retorikën politike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kryesisht në spektrin e djathtë partiak. Një fenomen i tillë u promovua jo vetëm nga eksponentë partiak, deputetë e kandidatë presidencial, por edhe nga vetë liderët kryesorë të partive politike, të cilët për efekte elektorale përdornin fjalor manipulues etno -nacionalist dhe pezhorativ ndaj tjetrit.

### Etnocentrizmi si platformë politike elektorale

Zagorka Golluboviq, eksperte e çështjeve të multikulturalizmit, duke trajtuar diskursin politik të përfaqësuesve politik, në veprën e saj "Unë dhe tjetri - Shqyrtime antropologjike rreth identitetit individual dhe kolektiv", ka konkluduar se "Disa deklarata tregojnë qartë se duke njëjtësuar patriotizmin me nacionalizmin, shumë politikanë në vend të mbrojtjes së popullit si demos kanë rënë në kurthin e etnosit si bashkësi e vetme «e pastër» që meriton shërbim. Në këtë vijë është krijuar lehtësisht lidhja mes politikanëve nacionalistë dhe elitave politike kombëtare, të cilat, duke gjallëruar "etnicitetin e fjetur" kanë instrumentalizuar ideologjitë kombëtare për të arritur pushtetin"[34].

Natyrisht se edhe Republika e Maqedonisë së Veriut nuk bën përjashtim nga instrumentalizimi politik i ideologjisë etnocentrike, meqë edhe Lidhja Socialdemokrate në vitet 90-ta përmes eksponentëve të saj kryesorë, ish presidentit në vitet 1991-1999, Kiro Gligorov dhe kryeministrit Branko Cërvenkovski në vitet 1992- 1998, zbatonte politikë që shpesh kishte qasje etnike maqedonase. Ngjashëm do të veprojë edhe VMRO-DPMNE-ja, e cila kishte qëndrime dhe pozicione deklarative më radikale etno-nacionaliste se sa LSDM-ja. Me narrativin e tillë, partia e djathtë maqedonase, VMRO-DPMNE rikthehet në pushtet në vitin 1998, 2006 dhe në zgjedhjet e fundit në vitin 2024.

## Qëndrimet dhe deklarimet etnonacionaliste dhe etnocentrike të politikanëve përgjatë historisë

Politikanët e Maqedonisë së Veriut, shqiptarë dhe maqedonas, sidomos të ideologjisë djathtiste, nuk kanë reshtur duke përdorur diskurs mediatik i cili ka qenë gjithmonë me tone negative ndaj shqiptarëve ose maqedonasve, duke i tendosur në këtë mënyrë marrëdhëniet ndëretnike dhe duke i bërë mediat zgjatime të diskursit polarizues shoqëror.

Deklarimet e përzgjedhura të politikanëve në këtë analizë lidhur me çështjet etnike flasin vetvetiu se në periudha të ndjeshme për vendin, politikanët për qëllime elektorale kanë përdorur gjuhë e cila favorizonte etninë së cilës i takonin dhe nënçmonte me terma dhe ide etninë të cilën e projektonin me ngjyrime kundërshtuese, për të mos thënë armiqësore. Transmetimi i tyre dhe ripërsëritja e tyre në momente të caktuara dhe në favor të agjendave të caktuara politike, mediat sikur i bëri palë të promovimit të gjuhës së urrejtjes etnike, gjë që është në kundërshtim me rolin e gazetarisë paqësore dhe multikulturore, e cila duhet të promovojë kohezion shoqëror dhe integrim ndëretnik.

- *"Unë ua thashë sot në Dibër dhe dje në Tetovë, duke iu drejtuar drejtpërdrejt shqiptarëve etnikë - nëse lëshojnë kthetra vendosmërisht do t'ua presim*". (Lubisha Georgievski, kandidat i VMRO- DPMNE-së për president në vitin 1994[35])
- "*Struktura sllavomaqedonase e fuqisë në këtë pikëpamje nuk bën dallim midis politikës së Millosheviqit dhe Gligorovit në Maqedoni*" (Arbër Xhaferi, ish lider i Partisë Demokratike Shqiptare)[36]. Arbër Xhaferi kur ishte në opozitë gjithmonë sistematikisht përdorte termat: Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe sllavomaqedonas për popullin maqedonas.
- "*Realiteti historik në Maqedoni, e di gjithë bota dhe është shumë absurde, kur një popull që s'ka identitet, që në rastin konkret janë maqedonasit, ndërsa shqiptarët kanë qenë shumë korrektë dhe ju kanë ndihmuar ta ndërtoni këtë identitet dhe ju tani kontestoni identitetin tonë. Merr regjistrimin para 100 viteve, nuk ekziston popull maqedonas. Nga ana tjetër, popujt i ndërtojnë identitetet, nuk lindin nga Zoti, edhe atë si pasojë e rrethanave politike dhe askush nuk e kontreston atë. Ju keni të drejtë ta quani veten si të doni, këto janë fakte historike. Ju hyni në çështje autoktonie dhe harroni që në shekullin e shtatë jeni të pranishëm këtu, përderisa ilirët janë shumë më herët.*" (Ziadin Sela, kryetar i partisë Aleanca për Shqiptarët)[37]. Kjo deklaratë e Selës në emisionin 200 të TV ALSAT ishte njëra ndër qëndrimet publike që motivoi disa huliganë më 27 prill të vitit 2017, ta sulmojnë rëndë, duke e lënë në korridoret e Kuvendit të Maqedonisë pa ndjenja, por pas dërgimit në spital shpëtoi.
- "*Populli ynë thotë se çdo e keqe për të mirë le të jetë. Ndërsa, unë në mënyrë të pakushtëzuar besoj tek* ***populli maqedonas dhe qytetarët e Maqedonisë***" (Hristijan Mickoski, kryetar i VMRO- DPMNE-së)[38].

## Përfundime

Në shoqërinë shumëetnike, shumëkulturore dhe shumëgjuhësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që nga periudha e pluralizmit politik përkatësisht mëvetësimit të shtetit nga ish federata jugosllave, ka qenë i pranishëm diskursi etnocentrik dhe populist në media dhe në politikë.

Diskursi i këtillë ka prodhuar stigmatizime të shumta dhe paragjykime e stereotipe etnike, por edhe fetare, të cilat janë shfaqur në përmbajtjet mediatike: lajme, intervista, debate televizive, programe humoristike dhe sidomos në programet kontaktuese, në të cilat qytetarët përmes linjës telefonike kanë mundur të japin mendimet dhe pikëpamjet e tyre, që fatkeqësisht në masë të madhe kanë qenë dhe janë përplot me gjuhë të urrejtjes dhe nënçmuese ndaj "tjetrit" kolektiv, kryesisht ndaj shqiptarëve, përkatësisht maqedonasve.

Në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të sivjetme, partitë politike kanë vënë fokusin tek çështjet etnike, përkatësisht tek mbrojtja e kauzës maqedonase dhe shqiptare. VMRO-DPMNE-ja në njërën anë dhe Fronti Evropian e VLENI në anën tjetër, ishin promovuesit e koncepteve etnocentrike. Mediat kanë qenë korrekte, por kryesisht jokritike në transmetimin e narrativëve të këtillë.

Mediat, kryesisht në mënyrë objektive dhe korrekte kanë transmetuar deklaratat përplasëse midis Ali Ahmetit dhe Hristijan Mickoskit lidhur me mospërfshirjen e BDI-së dhe përfshirjen e koalicionit VLEN në qeveri. Një media pati keqinterpretim të qëndrimit të Ahmetit si porosi politike për Mickoskin.

Deklarata e presidentes SIljanovska në cilësinë e kandidates se "lëndëve juridike të vitit 2001" nuk u skadon afati, nga një media dhe më pas edhe nga tjera u interpretua si kërkesë që rastet e vitit 2001 të rikthehen në Tribunalin e Hagës, të cilin presidentja nuk e kishte përmendur, që do të thotë se u plasua një informatë e pasaktë.

Diskursi etnocentrik dhe populist i partisë E Majta, por edhe i partisë së re ZNAM është shfaqur në mënyrë të zbehtë nga mediat maqedonase, ndërsa ato shqiptare gati se i kanë injoruar.

Etnocentrizmi si doktrinë politike shpesh është përdorur si platformë elektorale nga parti të caktuara, të cilat lehtësisht kanë krijuar besueshmëri tek qytetarët, duke u thirrur në kauzat e mëdha etnike apo etnokulturore. Nga vitet 90-ta gjithmonë është prodhuar dhe shfaqur "diskursi i dallimeve", i cili edhe sot, vazhdon ta dominojë skenën politike dhe me këtë edhe atë mediatike.

## Rekomandime

Mediat duhet të raportojnë mbi çështjet etnike, por nuk duhet të nxisin përkeqësimin e tyre, por me raportim korrekt dhe objektiv duhet të ndikojnë në rritjen e tolerancës, mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë mes komuniteteve të ndryshme etnike, ndërsa krijimi i kohezionit shoqëror është detyrë para së gjithash e shërbimit radiodifiziv publik.

Në spektrin mediatik të vendit, i jepet fokus i madh raportimit për konfliktet, mosmarrëveshjet dhe përplasjet midis komuniteteve etnike, në vend se tu jepet rëndësi vlerave që përbashkojnë. Konflikti mbi baza etnike shpesh prezantohet nën prizmin se sikur dallimet enike janë gjëja e vetme që e shpjegon një konflikt.

Shpjegimi i konflikteve dhe çështjeve etnike në mënyrë të thjeshtë, mund ta mbyll hapësirën për analizën e faktorëve politik, social dhe ekonomik dhe me këtë edhe ta pengojë publikun që të njihet me shkaqet e vërteta të konfliktit.

Kur raportojnë mbi çështjet etnike, gazetarët dhe mediat duhet t'i respektojnë rregullat dhe standardet e raportimit të diversiteteve. Kjo nënkupton që kur raportohet për një komunitet të caktuar duhet të konsultohen burime nga komuniteti dhe të mbahen kontakte me këto burime, pasi në atë mënyrë sigurohet jostereotipizim etnik në raportim. Mediat kanë për detyrë t'i promovojnë diversitetet, e për atë duhet ta fusin dhe mirëmbajnë konceptin e diversiteteve në redaksitë e tyre.

Kur raportohen deklarata origjinale, të cilat përmbajnë paragjykime, stereotipe ose gjuhë të urrejtjes, fjalor diskriminues apo fyes, ato duhet të kontekstualizohen dhe të shpjegohet se janë narrativë të dëmshme për shoqërinë, ndërsa media duhet të distancohet nga të njëjtat dhe transmetimi i tyre duhet të bëhet vetëm në rastet kur janë të domosdoshme për të shpjeguar një realitet të caktuar shoqëror.

Në një përmbajtje mediatike duhet të ketë këndvështrime të ndryshme, përkatësisht përfshirje të perspektivave të ndryshme gjatë interpretimit të ndonjë ngjarjeje apo çështje të caktuar ndëretnike.

Qasja në raportimin për konfliktet duhet të bazohet tek gazetaria paqësore, që synon t'i zgjidhë ato në mënyrë paqësore dhe që mundëson të kuptuarit e pamjes së përgjithshme mbi shkaqet, motivet dhe pasojat, që qëndrojnë pas vetë konflikteve.

*(Autori është profesor universitar në lëmine e gazetarisë dhe komunikimeve publike)*

## Referencat dhe burimet


1 Shih: TV 21, 22.04.2024, e qasshme në: https://tv21.tv/mickoski-eshte-rritur-me-gurabija-dhe-keksa-ahmeti-paralajmeron-mickoskin-fjale-pas-fjale-nise-belaja/

2 Shih: Almakos, 21.04.2024, e qasshme në: https://almakos.com/ali-ahmeti-i-drejtohet-mickoskit-je-rritur-me-gurabija-mati-fjalet-dhe-mos-nis-bela/

3 Shih: TV Klan Maqedoni, 21.04.2024, e qasshme në: https://tvklan.mk/ahmeti-mickoskit-mati-mire-fjalet-kur-flet-se-je-ende-i-ri-ardhmeria-e-ketij-vendi-eshte-vetem-ne-be/

4 Shih: Tetova Sot, 22.04.2024, e qasshme në: https://www.tetovasot.com/2024/04/2109577/

5 Shih: Nistori, 22.04.2024, e qasshme në: https://nistori.com/lajme/ahmeti-ne-shkup-uck-ja-eshte-ajo-qe-e-beri-maqedonine/

6 Shih: Time.mk, e qasshme në: https://time.mk/c/b87694702c/toj-porasna-na-gurabii-i-keksi-ahmeti-mu-vozvrati-na-mickoski.html

7 Shih: Kurir, 21.04.2024, e qasshme në: https://kurir.mk/vesti/makedonija/ahmeti-mu-se-zakani-na-mickoski-ne-si-ja-baraj-beljata/

8 Shih: Netpress, 21.04.2024, e qasshme në: https://netpress.com.mk/ahmeti-mu-se-zakani-na-mickoski-ne-si-a-bara-be-ata/

9 Shih: Republika, 21.04.2024, e qasshme në: https://republika.mk/vesti/makedonija/ahmeti-mu-se-zakani-na-mitskoski-ne-si-ja-baraj-belata/

10 Shih: PressingTV, 21.04.2024, e qasshme në: https://pressingtv.mk/makedonija/ahmeti-mu-se-zakani-na-mitskoski-ne-si-ja-baraj-belata/

11 Shih: Lider.mk, 21.04.2024, e qasshme në: https://lider.mk/ali-ahmeti-so-otvorena-zakana-do-hristijan-mickoski-kje-ti-ja-zakrpam-ustata/

12 Shih: Lajmpress, 22.04.2024, e qasshme në: https://lajmpress.org/mickoski-i-pergjigjet-ahmetit-gurabijet-dhe-qumeshti-do-te-jungecin-ne-fyt/

13 Shih: Pa Censurë, 22.04.2024, e qasshme në: https://www.pacensure.com/mickoski-i-pergjigjet-ali-ahmetit-kercenimet-vijne-nga-nje-burre-para-daljes-ne-pension-politik-dhe-pak-i-harruar/

14 Shih: Tetova Sot, 22.04.2024, e qasshme në: https://www.tetovasot.com/2024/04/mickoski-ia-kthen-porosine-ahmetit/

15 Shih: INA Online, 22.04.2024, e qasshme

në: https://ina-online.net/mickoski-ia-kthen-porosine-ahmetit/
16 Shih: Fakti Ditor, 22.04.2024, e qasshme në: https://www.faktiditor.ch/mickoski-ia-kthen-porosine-ahmetit-pasi-i-tha-do-gjesh-belane/
17 Shih: Open TV, 22.04.2024, e qasshme në: https://open-tv.mk/mickoski-ia-kthen-porosine-ahmetit
18 Shih: Gazeta Express, e qasshme në: https://www.gazetaexpress.com/angellov-porosi-ahmetit-pas-mickoskit-qendrojne-branitellat/
19 Shih: Lajmpress, 22.04.2024, e qasshme në: https://lajmpress.org/angellov-porosi-ahmetit-pas-mickoskit-qendrojne-branitellat/
20 Shih: Tetova Sot, 22.04.2024, e qasshme në: https://www.tetovasot.com/2024/04/angellov-porosi-ahmetit-pas-mickoskit-qendrojne-branitellat/
21 Shih: Syri, 22.04.2024, e qasshme në: https://syri.mk/angellov-porosi-ahmetit-pas-mickoskit-qendrojne-branitellat/
22 Shih: grumbulluesi i lajmeve në gjuhën shqipe fax.al, e qasshme në: https://fax.al/news/40595253/mickoski-eshte-rritur-me-gurabija-dhe-keksa-ahmeti-paralajmeron-mickoskin-fjale-pas-fjale-nise-belaja
23 Shih: grumbulluesi i lajmeve në gjuhën maqedonase Time.mk, e qasshme në: https://time.mk/c/50f5e2e882/mickoski-mu-vrati-na-ahmeti-mnogu-brzo-od-denes-i-keksito-i-mlekoto-ke-ti-presednat.html
24 Shih: grumbulluesi i lajmeve në gjuhën shqipe fax.al, e qasshme në: https://fax.al/news/40653933/siljanovska-propozoi-tribunal-nderkombetar-per-luften-e-vitit-2001
25 Shih: https://alsat.mk/mk/siljanovska-reche-deka-vojnata-od-2001-treba-da-dobie-razreshnitsa-pred-megunaroden-sud/
26 Shih: Tetova Sot, 29.04.2024, e qasshme në: https://www.tetovasot.com/2024/04/nga-tribunal-nderkombetar-per-luften-e-2001-se-deri-tek-mos-besimi-te-ata-qe-kerkojne-anulimin-e-marreveshjeve-qe-sollen-paqe/
27 Shih: TV News, 29.04.2024, e qasshme në: https://tvnews.mk/2024/04/30/fushata-presidenciale-nga-tribunal-nderkombetar-per-luften-e-2001-se-deri-tek-mos-besimi-te-ata-qe-kerkojne-anulimin-e-marreveshjeve-qe-sollen-paqe/
28 Shih: Infoshqip, 29.04.2024, e qasshme në: https://www.infoshqip.com/fushata-presidenciale-nga-tribunal-nderkombetar-per-luften-e-2001-se-deri-tek-mos-besimi-te-ata-qe-kerkojne-anulimin-e-marreveshjeve-qe-sollen-paqe/
29 Shih: grumbulluesi i lajmeve fax.al, e qasshme në: https://fax.al/news/40653933/siljanovska-propozoi-tribunal-nderkombetar-per-luften-e-vitit-2001
30 Shih: TV 21, 30.04.2024, e qasshme në: https://tv21.tv/siljanovska-propozoi-tribunal-nderkombetar-per-luften-e-vitit-2001/
31 Shih: Triling, 15.03.2024, e qasshme në: https://triling.mk/%D0%B2%D0%B8%D0%B4%D0%B5%D0%BE-%D1%81%D0%B8%D0%BB%D1%98%D0%B0%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D1%81%D0%BA%D0%B0-%D0%B4%D0%B0%D0%B2%D0%BA%D0%BE%D0%B2%D0%B0-%D0%B1%D0%B5%D0%B7-%D0%BE%D0%B3%D0%BB%D0%B5%D0%B4-%D0%BD/
32 Shih: grumbulluesi i lajmeve Time.mk, e qasshme në: https://time.mk/c/17303a1e28/apasiev-pod-vlasta-na-uckite-od-dui-poddrzani-od-korumpiranata-makedonska-elita-sekoe-vtoro-dete-od-polog-se-ragja-vo-svajcarija.html
33 Shih: Racin, 02.05.2024, e qasshme në: https://racin.mk/vesti/foto-dimitrievski-od-znam-vo-zhelba-za-vlast-gi-razvea-verginite/
34 Shih: Zagorka Golubović, Ja i drugi: antropološka istraživanja individualnog i kolektivnog identiteta, 1999
35 Shih: Ljubisha Georgievski gjatë fushatës zgjedhore në 1994, e qasshme në: https://www.youtube.com/watch?v=4I-zDb91Z6E
36 Shih: Димитар Мирчев, БАЛКАНСКИОТ МЕГАЕТНИКУМ - НАЦИОНАЛНИТЕ ДОКТРИНИ НА МАКЕДОНСКИТЕ СОСЕДИ, 2015, e qasshme në: http://www.pollitecon.com/html/ebooks/risto-stefov/Balkanskiot-megaetnikum.pdf
37 Shih: Emisioni 200, TV Alsat, 29.11.2016, e qasshme në: https://www.youtube.com/watch?v=IdJ9DxYASxg
38 Shih: Hristijan Mickoski, konferencë për shtyp 18.10.2019, burimi TV24, e qasshme në: https://24.mk/details/mickoski-povikuvam-na-sredba-na-drzhavniot-vrv-izborite-se-logichno-reshenie-vo-me-uvreme-potrebni-se-itni-reformi

